LIGJ
Nr.9840, datë 10.12.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR RREGULLAT E BASHKËPUNIMIT PËR ASISTENCËN PËR SHQIPËRINË, NË KUADËR TË ZBATIMIT TË INSTRUMENTIT TË PARAZGJERIMIT (IPA)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)"

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5562, datë 27.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE KUADËR
NDËRMJET QEVERISË SË (VENDIT) DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE, PËR RREGULLAT E BASHKËPUNIMIT NË LIDHJE ME
NDIHMËN FINANCIARE TË KE-SË NDAJ (VENDIT) NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË NDIHMËS SIPAS INSTRUMENTIT PËR ASISTENCË PARAZGJERIMI (IPA-S) E DATËS ( )

Komisioni i Komuniteteve Europiane, referuar si "Komisioni", që vepron për, dhe në emër të Komunitetit Europian, referuar këtu si "Komuniteti", nga njëra anë dhe qeveria e (vendit), që vepron në emër të (vendit), referuar si "Përfituesi" dhe së bashku të bashkëreferuara këtu si "Palët Kontraktuese",

duke marrë parasysh se:

1. Më 1 gusht 2006 Këshilli i Bashkimit Europian miratoi rregulloren nr.1085/2006 (KE), datë 17 korrik 2006[1] mbi krijimin e një instrumenti për ndihmën e parazgjerimit (referuar si "Rregullorja kuadër IPA"). Me veprim nga 1 janari 2007, ky instrument i ri përbën bazën e vetme ligjore për dhënien e ndihmës financiare vendeve kandidate dhe kandidate potenciale në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me synimin për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Europian.

2. Më 12 qershor 2007, Komisioni ka miratuar rregulloren që zbaton rregulloren kuadër IPA, duke dhënë hollësira për menaxhim zbatues dhe dispozita kontrolli.

3. Instrumenti i ri për asistencë parazgjerimi (IPA) zëvendëson pesë instrumentet e mëparshme ekzistuese të parazgjerimit. Rregulloren nr.3906/1989 (EEC) për ndihmën ekonomike ndaj disa vendeve të Europës Lindore e Qendrore, rregulloren nr.1267/1999 (EC) për krijimin e një instrumenti për politikat strukturale për parazgjerim, rregulloren nr.1268/1999 (EC) mbi ndihmën për masat parazgjerim për bujqësinë dhe zhvillimin rural, rregulloren nr.2666/2000 për asistencën për Shqipërinë, Bosnjë Hercegovinën, Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë që shfuqizon rregulloren nr.1628/96 (EC) dhe amendon rregulloret nr.3906/89 (EEC) dhe nr.1360/90 (EEC) dhe vendimet 97/256/EC dhe 1999/31/EC dhe rregulloren nr.2500/2001 (EC) për

[1] FZ L 210, 31 korrik 2006, faqe 82.

ndihmën financiare ndaj Turqisë.

4. Përfituesi është i përzgjedhur sipas IPA-s siç parashikohet në rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e Komisionit nr.718/2007, datë 12 qershor 2007.[2] që zbaton rregulloren kuadër IPA, (referuar si "Rregullore zbatuese e IPA").

Për vendet kandidate:

Përfituesi figuron në aneksin I të rregullores kuadër IPA dhe, kështu do të ketë akses në 5 komponentët e krijuar sipas IPA-s d.m.th. në komponentin e asistencës së transicionit dhe ngritjes institucionale, komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar, komponentin e zhvillimit rajonal, komponentin e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe komponentin e zhvillimit rural.

Për vendet kandidate potenciale:

5. Përfituesi tashmë figuron në aneksin II të rregullores kuadër IPA dhe duhet kështu të ketë akses në komponentin e asistencës së transicionit dhe ngritjes institucionale dhe komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar, krijuar sipas IPA-s dhe, sapo Përfituesi të ketë fituar statusin e vendit kandidat dhe figuron në aneksin I të rregullores së përmendur, aksesi për 3 komponentët e tjerë do të hapet në parim për Përfituesin.

6. Është kështu e nevojshme të vendosen rregullat për bashkëpunim, përsa i përket ndihmës financiare KE me Përfituesin sipas IPA,

kanë rënë dakord si më poshtë:

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Interpretimi

1. Duke iu nënshtruar ndonjë dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje kuadër, termat e përdorur në këtë Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim siç u atribuohet atyre në rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren zbatuese të IPA.

2. Duke iu nënshtruar ndonjë dispozite të shprehur në kundërshtim me këtë Marrëveshje kuadër, referencat për këtë Marrëveshje janë referenca për marrëveshje të tilla si të ndryshuara, të plotësuara ose të zëvendësuara herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Komisionit ose Këshillit bëhet sipas versionit të këtyre rregulloreve siç tregohet, nëse kërkohen, modifikimet e këtyre rregulloreve do të transpozohen në këtë Marrëveshje kuadër me anë të amendamenteve.

4. Nëntitujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 2
Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimta

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje bëhet e pavlefshme ose nëse kjo Marrëveshje përmban mangësi të paqëllimta, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët Kontraktuese do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila i afrohet sa të jetë e mundur qëllimit të dispozitës së paqëllimtë. Palët Kontraktuese do të plotësojnë çdo mangësi (boshllëk) të paqëllimtë me një dispozitë, e cila i përshtatet më mirë qëllimit dhe synimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren zbatuese IPA.

Neni 3
Qëllimi

1. Me qëllim për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe për të ndihmuar

[2] FZ L 210, 29 qershor 2007, faqe 1.

Përfituesin në bashkërendimin progresiv me standardet dhe politikat e Bashkimit Europian, përfshirë ku të jetë e përshtatshme *acquis communautaire*, në lidhje me anëtarësimin, Palët Kontraktuese bien dakord të zbatojnë aktivitete në fusha të ndryshme, siç specifikohen në dy rregulloret e lartpërmendura dhe të zbatueshme për Përfituesin.

2. Aktivitetet e asistencës do të financohen dhe zbatohen brenda kuadrit ligjor, administrativ dhe teknik të përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe më hollësisht në marrëveshjet sektoriale dhe/ose marrëveshjet financiare, nëse ka.

3. Përfituesi ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme me qëllim për të siguruar kryerjen e duhur të të gjitha aktiviteteve të asistencës dhe për të lehtësuar zbatimin e programeve që lidhen me të.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme për asistencën financiare

1. Parimet e mëposhtme do të zbatohen për ndihmën financiare nga Komuniteti sipas IPA:

a) asistenca do të respektojë parimet e koherencës, plotësueshmërisë, koordinimit, partneritetit dhe koncentrimit;

b) asistenca do të jetë koherente me politikat e BE-së dhe do të mbështesë përputhshmërinë me *acquis communautaire*;

c) asistenca do të përputhet me parimet buxhetore të përcaktuara në rregulloren e Këshillit (KE, Euroatom) nr.1605/2002 të 25 qershorit 2002(3) për rregulloren financiare e zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane (në vijim e emërtuar si "Rregullore financiare") dhe rregullat e saj plotësuese[4];

d) asistenca do të jetë në përputhje me nevojat e identifikuara gjatë procesit të zgjerimit dhe kapaciteteve përthithëse të Përfituesit. Ajo gjithashtu do të marrë parasysh mësimet e nxjerra;

e) planifikimi dhe zbatimi i asistencës nga Përfituesi do të nxitet, si dhe do sigurohet qartësi e mjaftueshme e ndërhyrjes së BE;

f) operacionet do të përgatiten me objektiva të qartë dhe të verifikueshëm, të cilët do të realizohen brenda një periudhe të caktuar; rezultatet e arritura duhet të vlerësohen nëpërmjet treguesve të matshëm qartë dhe të mjaftueshëm;

g) çdo diskriminim i mbështetur në seks, origjinë etnike ose raciale, fe ose besim, paaftësi, moshë ose orientim seksual do të parandalohet gjatë stadeve të ndryshme të zbatimit të asistencës;

h) objektivat e asistencës parazgjerim do të ndiqen në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe synimit të mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit të promovuar nga Komuniteti.

Për vendet kandidate:

Asistenca për Përfituesin do të mbështetet në prioritetet e identifikuara në dokumentet ekzistuese d.m.th. partneriteti europian, partneriteti i aderimit, nëse është i përshtatshëm, programi kombëtar për miratimin e acquis communautaire, raportet dhe dokumenti i strategjisë të përfshirë në paketën e zgjerimit vjetor të Komisionit, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, nëse është e përshtatshme dhe kuadri negociator.

Për vendet kandidate potenciale:

2. Asistenca do të bazohet në parimet e identifikuara në dokumentet ekzistuese d.m.th. partneriteti europian, nëse është i përshtatshëm, raportet dhe dokumentin e strategjisë të përfshirë në paketën e zgjerimit vjetor të Komisionit dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, nëse është e përshtatshme. Sapo Përfituesi të ketë marrë statusin e një vendi kandidat dhe figuron në aneksin I të rregullores kuadër IPA, asistenca për (vendin) mund të mbështetet, gjithashtu, në prioritetet e identifikuara te partneriteti i aderimit, nëse është i përshtatshëm, programi kombëtar për miratimin e acquis communautaire dhe kuadri negociator.

3. Të gjitha aktivitetet që marrin asistencë nga IPA do të kërkojnë në parim bashkëfinancim nga Përfituesi dhe Komuniteti, veç nëse është rënë dakord në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financiare.

4. Aty ku zbatimi i aktiviteteve varet nga angazhimet financiare të burimeve të Përfituesit ose nga burime fondesh të tjera, financimi i Komunitetit do të jetë i mundshëm në një kohë të tillë, kur angazhimet financiare të Përfituesit dhe/ose burimeve të fondeve të tjera bëhen të mundshme.

---

[3] FZ L 248, 16 shtator 2002, faqe 1 e amenduar nga rregullorja nr.1995/2006 e 13 qershorit 2006 (FZ L 390, 30 dhjetor 2006, faqe 1).

[4] Rregullorja e Komisionit (KE, Euroatom) nr.2342/2002 e 23 dhjetorit 2002 ku përcaktohen rregullat e detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit (KE, Euroatom) nr.1605/2002 (FZ L357, 31.12.2002, faqe 1) e amenduar së fundmi nga rregullorja e Komisionit nr.478/2007 e 23 prillit 2007 (FZ L 111, 28.4.2007).

5. Dispozita e Komunitetit për financim sipas IPA-s do të priret ndaj realizimit të detyrimeve nga Përfituesi, sipas kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe sipas marrëveshjeve sektoriale dhe financiare, nëse ka.

Neni 5
Metodat për zbatimin

1. Për zbatimin e asistencës sipas IPA në (vend), menaxhimi i decentralizuar përmes të cilit Komisioni lejon menaxhimin e disa veprimeve nga Përfituesi, ndërsa mban përgjegjësi të plotë përfundimtare për ekzekutimin e buxhetit të përgjithshëm në përputhje me nenin 53c të rregullores financiare dhe të dispozitave përkatëse të traktateve KE, si rregull do të zbatohet. Menaxhimi i decentralizuar do të mbulojë së paku tenderimin, kontraktimin dhe pagesat nga administrata kombëtare e Përfituesit. Operacionet do të zbatohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 53c të rregullores financiare dhe atyre të referuara në këtë nen.

2. Megjithatë, Palët Kontraktuese mund të bien dakord për të shfrytëzuar:

a) menaxhimin e centralizuar siç përcaktohet në nenin 53a të rregullores financiare, sipas komponentit të asistencës së transicionit dhe mbështetjes institucionale, në veçanti për programet horizontale dhe rajonale, dhe sipas komponentit të bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu, mund të përdoret për asistencë teknike nën një nga komponentët e IPA-s. Operacionet do të zbatohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 53 pika (a), 53a dhe 54 deri 57 të rregullores financiare;

b) menaxhimin e përbashkët siç përcaktohet në nenin 53d të rregullores financiare për komponentin e asistencës së transicionit dhe mbështetjes institucionale, në veçanti për programe horizontale dhe rajonale, dhe për programe që përfshijnë organizata ndërkombëtare. Operacionet do të zbatohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 53 pika (c) dhe 53d të rregullores financiare;

c) bashkëmenaxhimin siç përcaktohet në nenin 53b të rregullores financiare, sipas komponentit të bashkëpunimit ndërkufitar, për programe ndërkufitare që përfshijnë Shtete Anëtare të Bashkimit Europian. Operacionet do të zbatohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 53 pika (b), 53b dhe titullin II të pjesës së dytë të rregullores financiare. Dispozita e veçantë më poshtë do të merret parasysh në zbatimin e programeve ndërkufitare me Shtetet Anëtare.

Nëse një a më shumë Shtete Anëtare të Bashkimit Europian dhe Përfituesi që marrin pjesë në një program ndërkufitar nuk janë ende gati për zbatimin e të gjithë programit, sipas bashkëmenaxhimit, pjesa e programit në lidhje me shtetin(et) anëtar(e) do të zbatohet në përputhje me titullin II (Komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar), kapitulli III, seksioni 2 i rregullores implementuese IPA (Neni 101 deri 138) dhe pjesa e programit që lidhet me Përfituesin do të zbatohet në përputhje me titullin II, kapitulli III, seksioni 3 i rregullores implementuese IPA. (Nenet 139 deri 146 të rregullores implementuese IPA, me përjashtim të nenit 142. Dispozitat në lidhje me komitetin monitorues të përbashkët të nenit 110 do të zbatohen).

3. Nëse kërkohet nga vendimi financiar, Komisioni dhe Përfituesi do të përfundojnë një marrëveshje financiare në përputhje me nenin 8 të rregullores implementuese IPA për programet shumëvjeçare ose vjetore. Marrëveshja financiare mund të përfundohet ndërmjet Komisionit dhe disa vendeve përfituese sipas IPA-s, duke përfshirë Përfituesin për asistencë për programet shumëvendëshe dhe iniciativat horizontale.

4. Kjo Marrëveshje kuadër do të zbatohet në të gjitha marrëveshjet financiare të përfunduara ndërmjet Palëve Kontraktuese për asistencën financiare sipas IPA, nëse ato ekzistojnë, marrëveshjet sektoriale që lidhen me një komponent të dhënë do të zbatohen në të gjitha marrëveshjet financiare të përfunduara sipas atij komponenti. Nëse nuk ka ndonjë marrëveshje financiare, rregullat e përfshira në këtë Marrëveshje kuadër do të zbatohen së bashku me marrëveshjet sektoriale, nëse ka.

SEKSIONI II
STRUKTURAT E MENAXHIMIT DHE AUTORITETET

Neni 6
Krijimi dhe përcaktimi i strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin e decentralizuar

1. Strukturat dhe autoritetet e mëposhtme duhet të përcaktohen nga Përfituesi në rastin e menaxhimit të decentralizuar:

a) zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA);

b) koordinatori kombëtar i instrumentit të parazgjerimit (KKIPA);

c) koordinatori strategjik për komponentin e zhvillimit rajonal dhe komponentin e burimeve njerëzore;

d) zyrtari kombëtar i autorizuar (ZKA);

e) fondi kombëtar (FK);

f) strukturat operuese, sipas komponentit ose programit, për të trajtuar menaxhimin dhe zbatimin e asistencës sipas rregullores IPA;

g) autoriteti i auditimit.

2. Njësi specifike mund të ngrihen brenda kuadrit të përgjithshëm të përcaktuar nga njësitë dhe autoritetet e përshkruara më sipër ose jashtë strukturave të përcaktuara në fillim. Përfituesi do të sigurojë që përgjegjësia përfundimtare për funksionet e strukturave operuese do të mbetet në strukturën operuese të përcaktuar në fillim. Ky rikonstruktim do të formalizohet në marrëveshje me shkrim dhe do të pritet për akreditimin nga zyrtari kombëtar i autorizuar dhe dhënien e menaxhimit nga Komisioni.

3. Përfituesi do të sigurojë që ndarja e përshtatshme e detyrave t'u adresohet njësive dhe autoriteteve të referuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, në përputhje me nenin 56(2) të rregullores financiare. Detyrat ndahen kur detyra të ndryshme të lidhura me një transaksion u caktohen stafeve të ndryshme, në këtë mënyrë duke ndihmuar të sigurohet që çdo detyrë e veçantë të jetë ndërmarrë me të drejtë.

Neni 7

Krijimi dhe përcaktimi i strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin e përbashkët ose të centralizuar

1. Në rast menaxhimi të përbashkët ose të centralizuar, koordinatori kombëtar i instrumentit të parazgjerimit (KKIPA) do të veprojë si përfaqësues i Përfituesit në marrëdhënie me Komisionin. Ai do të sigurojë që të mbahet një lidhje e ngushtë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit, përsa i përket procesit të përgjithshëm të aderimit, si dhe asistencës së parazgjerimit KE sipas IPA.

2. Koordinatori Kombëtar i IPA (KKIPA) do të jetë gjithashtu përgjegjës për të bashkërenduar pjesëmarrjen e Përfituesit në programet ndërkufitare përkatëse, me shtetet anëtare dhe vende të tjera Përfituese, si dhe në programet tejkombëtare, ndërrajonale sipas instrumenteve të tjera komunitare. Ai mund t'ia delegojë detyrat, përsa i përket përgjegjësisë së fundit, një koordinatori të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Në rastin e komponentit ndërkufitar, strukturat operuese do të përcaktohen dhe vendosen nga Përfituesi, në përputhje me nenin 139 të rregullores zbatuese IPA.

Neni 8

Funksionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave, autoriteteve dhe njësive

1. Njësive dhe autoriteteve të përmendura në nenin 6 më sipër do t'u akordohen funksionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta, ashtu si deklarohen në aneksin A në këtë Marrëveshje kuadër.

2. Akordimet specifike komponentlidhëse të funksioneve dhe përgjegjësive, mund të deklarohen në marrëveshjet sektoriale ose marrëveshjet financiare. Ato nuk duhet të jenë në kundërshtim me përqasjen themelore të zgjedhur për përcaktimin e funksioneve dhe përgjegjësitë e përbashkëta, siç tregohen në aneksin A.

3. Nëse sipas menaxhimit të decentralizuar, personave të veçantë iu është dhënë përgjegjësi për një aktivitet në lidhje me menaxhimin, zbatimin dhe kontrollin e programeve, Përfituesi do t'i mundësojë këta persona të ushtrojnë detyrat e shoqëruara me atë përgjegjësi që përfshin rastet ku: nuk ka lidhje hierarkike midis tyre dhe njësive që marrin pjesë në atë aktivitet. Përfituesi do t'u japë, në veçanti këtyre personave autoritetin të krijojnë, përmes marrëveshjeve formale të punës midis atyre dhe njësive të interesuara:

a) një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë kompetencën për të kërkuar informacion dhe të drejtën për akses në dokumentet dhe stafin aty në vend, nëse është e nevojshme;

b) standardet që duhet të plotësohen;

c) procedurat që duhet të ndiqen.

SEKSIONI III

AKREDITIMI DHE DHËNIA E KOMPETENCAVE MENAXHUESE SIPAS MENAXHIMIT TË DECENTRALIZUAR

Neni 9
Kërkesa të përbashkëta

Menaxhimi që lidhet me një komponent, një program apo një masë mund të jepet për (vendin) vetëm, nëse dhe kur përgjegjësitë e mëposhtme realizohen:

a) Përfituesi plotëson kushtet e vendosura në nenin 56 të rregullores financiare, në veçanti përsa i përket menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit. Menaxhimi dhe sistemet e kontrollit të ngritura në (vend) do të parashikojnë kontroll efektiv dhe frytdhënës së paku te zonat e deklaruara në aneksin e rregullores implementuese IPA dhe siç është listuar sipas nr.1c) të aneksit A të kësaj Marrëveshje kuadër. Palët Kontraktuese mund të përcaktojnë dispozita shtesë në marrëveshjet sektoriale ose marrëveshjet financiare.

b) Zyrtari përgjegjës akreditues i ka dhënë akreditim zyrtarit kombëtar të autorizuar për të dyja:

si kryetar i fondit kombëtar që mban përgjegjësi të plotë për menaxhimin financiar të fondeve të KE në (vend) dhe përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë;

përsa i përket kapacitetit të zyrtarit kombëtar të autorizuar për të përmbushur përgjegjësitë për funksionimin efektiv të menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit sipas IPA-s.

Akreditimi i zyrtarit kombëtar të autorizuar, do të mbulojë gjithashtu fondin kombëtar siç përshkruhet në aneksin A, 5.

c) Zyrtari kombëtar i autorizuar ka dhënë akreditim për strukturat operuese përkatëse.

Neni 10
Procedura për akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar dhe fondi kombëtar nga zyrtari përgjegjës akreditues

1. Akreditimi i zyrtarit kombëtar të autorizuar sipas nenit 11 të rregullores zbatuese IPA është subjekt i plotësimit nga ana e tij të kërkesave të zbatueshme të përcaktuara në nenin 11 të rregullores së përmendur dhe si e përcaktuar më tej në aneksin A, 4. Ky akreditim do të mbështetet nga një opinion auditi i hartuar nga një auditues i jashtëm funksionalisht i pavarur nga të gjithë aktorët në menaxhimin dhe sistemin e kontrollit. Opinioni i auditit do të mbështetet në ekzaminimet e kryer në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtare të auditit.

2. Zyrtari përgjegjës akreditues, do të njoftojë Komisionin për akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar, jo më vonë se shpallja e akreditimit të strukturës së parë operative. Zyrtari përgjegjës akreditues do të japë të gjithë informacionin mbështetës përkatës të kërkuar nga Komisioni.

Zyrtari përgjegjës akreditues do të informojë menjëherë Komisionin për çdo ndryshim që lidhet me zyrtarin kombëtar të autorizuar ose fondin kombëtar. Nëse një ndryshim ndikon zyrtarin kombëtar të autorizuar ose fondin kombëtar në lidhje me kërkesat e zbatueshme siç përcaktohen në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA, zyrtari përgjegjës akreditues do t'i dërgojë Komisionit një vlerësim të pasojave të një ndryshimi të tillë për vlefshmërinë e akreditimit. nëse një ndryshim i tillë është i rëndësishëm, zyrtari përgjegjës akreditues, do të njoftojë gjithashtu Komisionin për vendimin e tij, përsa i përket akreditimit.

Neni 11
Procedura për akreditimin e strukturave operuese nga zyrtari kombëtar i autorizuar

1. Akreditimi i një strukture operuese është çështje e përmbushjes nga ana e tij të kërkesave të dhëna në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA. Kjo siguri do të mbështetet nga një opinion auditi i hartuar nga një auditues i jashtëm, funksionalisht i pavarur nga të gjithë aktorët në menaxhimin dhe sistemin e kontrollit. Opinioni i auditit do të bazohet në kontrolle të drejtuara në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të auditit.

2. Zyrtari kombëtar i autorizuar do të njoftojë Komisionin për akreditimin e strukturave operuese dhe do të japë të gjithë informacionin mbështetës përkatës të kërkuar nga Komisioni, duke përfshirë një përshkrim të menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit.

Neni 12
Procedura për dhënien e kompetencave menaxhuese nga Komisioni

Komisioni jep kompetenca menaxhimi për Përfituesin, vetëm pasi njësitë dhe autoritetet e referuara në nenin 6 më sipër janë përcaktuar dhe ngritur, si dhe kushtet e përcaktuara në këtë nen janë plotësuar.

Para dhënies së kompetencave të menaxhimit, Komisioni rishikon akreditimet e zyrtarit përgjegjës akreditues dhe strukturat operuese ashtu siç janë të përcaktuara në nenet 10 dhe 11 më sipër dhe kontrollon procedurat e strukturat, të çdo njësie apo autoriteti përkatës brenda (vendit). Kjo mund të përfshijë verifikime të menjëhershme në vend nga shërbimet e Komisionit ose të nën-kontraktuara në një firmë auditimi.

Komisioni mund, në vendimin e tij për të dhënë kompetenca menaxhimi, të vendosë kushte të mëtejshme, me qëllim të sigurojë se janë plotësuar kërkesat e referuara në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA. Këto kushte të mëtejshme duhet të plotësohen brenda një periudhe fikse të caktuar nga Komisioni për dhënien e kompetencave të menaxhimit për të mbetur efektivë.

Vendimi i Komisionit për dhënien e kompetencave të menaxhimit do të përcaktojë listën për kontrollet *ex ante*, nëse ka, që do kryhen nga Komisioni për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve. Kjo listë mund të ndryshojë me komponentin ose programin. Kontrollet ex ante do të zbatohen për komponentin ose programin, derisa Komisioni të lejojë menaxhimin e decentralizuar pa kontrolle *ex ante*, siç përmendet në nenin 16 më poshtë.

Neni 13

Tërheqja ose pezullimi i akreditimit të zyrtarit kombëtar të autorizuar dhe fondit kombëtar

1. Pas dhënies së kompetencave të menaxhimit nga Komisioni, zyrtari përgjegjës akreditues do të jetë përgjegjës për monitorimin e plotësimit të vazhdueshëm të kërkesave për akreditim dhe do të informojë Komisionin për çdo ndryshim të rëndësishëm.

2. Nëse disa kërkesa të zbatueshme të shpallura në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA, nuk janë plotësuar ose nuk janë plotësuar për një kohë të gjatë, zyrtari përgjegjës akreditues do të pezullojë ose do të tërheqë akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar dhe do të informojë menjëherë Komisionin për vendimin e tij dhe për arsyet e vendimit të tij. Zyrtari përgjegjës akreditues do të sigurohet që ato kërkesa të plotësohen përsëri para dhënies së akreditimit. Kjo siguri do të mbështetet nga një opinion audit, siç specifikohet në nenin 10(1) më sipër.

3. Nëse akreditimi i zyrtarit kombëtar të autorizuar tërhiqet ose pezullohet nga zyrtari përgjegjës akreditues, do zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- Komisioni ndërpret bërjen e transfertave të fondeve për Përfituesin gjatë periudhës, kur akreditimi nuk është në fuqi;
- Gjatë periudhës kur akreditimi nuk është në fuqi, të gjitha llogaritë në euro ose llogaritë në euro për komponentët përkatës do të bllokohen dhe asnjë pagesë e bërë nga fondi kombëtar nga këto llogari në euro të cilat janë të bllokuara nuk do të konsiderohet e përzgjedhur për financim komunitar;
- Pa cenuar ndonjë rregullim tjetër financiar, Komisioni mund të bëjë korrigjime financiare siç përcaktohen në nenin 30 më poshtë përkundrejt Përfituesit në lidhje me mospajtueshmërinë e tij të mëparshme me kërkesat për dhënien e kompetencave të menaxhimit.

Neni 14

Tërheqja ose pezullimi i akreditimit të strukturave operuese

Pas dhënies së kompetencave të menaxhimit nga Komisioni, zyrtari kombëtar i autorizuar do të jetë përgjegjës për plotësimin në mënyrë të vazhdueshme të kërkesave për këtë akreditim dhe do të informojë Komisionin dhe zyrtarin përgjegjës akreditues për çdo ndryshim të rëndësishëm që ka lidhje me të.

Nëse ndonjë nga kërkesat e paraqitura në nenin 11 të rregullores zbatuese të IPA nuk është ose nuk është plotësuar më, zyrtari kombëtar i autorizuar ose pezullon, ose tërheq akreditimin e strukturës operuese përkatëse dhe informon menjëherë Komisionin dhe zyrtarin përgjegjës akreditues për vendimin dhe arsyet e tij.

Zyrtari kombëtar i autorizuar sigurohet që këto kërkesa do të plotësohen para dhënies së akreditimit përkatës. Kjo siguri do mbështetet nga një opinion auditi, siç referohet në nenin 11(1) më sipër.

Nëse akreditimi i një strukture operuese tërhiqet ose pezullohet zyrtari kombëtar i autorizuar, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

Komisioni nuk do të bëjë asnjë transfertë te Përfituesi i fondeve, përsa i përket programeve ose

operacioneve të zbatuara nga struktura operuese përkatëse, ndërsa akreditimi i saj është pezulluar apo tërhequr.

Pa cenuar ndonjë korrigjim tjetër financiar, Komisioni mund të bëjë korrigjime financiare siç përcaktohen në nenin 30 më poshtë përkundrejt Përfituesit, në lidhje me mospajtueshmërinë e tij me kërkesat dhe kushtet për dhënien e kompetencave të menaxhimit.

Asnjë angazhim i ri ligjor bërë nga struktura operuese përkatëse nuk do të konsiderohet i përzgjedhur gjatë periudhës kur akreditimi nuk është në fuqi.

Zyrtari kombëtar i autorizuar do të jetë përgjegjës për marrjen e ndonjë mase mbrojtëse të përshtatshme, përsa i përket pagesave të bëra ose kontratave të nënshkruara nga struktura operuese përkatëse.

Neni 15

Tërheqja ose pezullimi i dhënies së kompetencave të menaxhimit

Komisioni do të monitorojë pajtueshmërinë me kërkesat e paraqitura në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA.

Pavarësisht nga vendimi nga zyrtari përgjegjës akreditues për të mbajtur, pezulluar ose tërhequr akreditimin e zyrtarit kombëtar të autorizuar, ose të vendimit të zyrtarit kombëtar të autorizuar për të mbajtur, pezulluar ose tërhequr akreditimin e strukturës operuese, Komisioni mund të tërheqë ose të pezullojë dhënien e kompetencave menaxhuese në çdo kohë, në veçanti në rast se ndonjë nga kërkesat e përmendura në nenin 11 të rregullores zbatuese IPA nuk janë plotësuar ose nuk plotësohen më.

Nëse dhënia e kompetencave të menaxhimit tërhiqet ose pezullohet nga Komisioni, dispozitat e mëposhtme do të zbatohen:

Komisioni ndërpret bërjen e transfertave të fondeve te Përfituesi.

Pa cenuar ndonjë korrigjim tjetër financiar, Komisioni mund të bëjë korrigjime financiare siç përcaktohen në nenin 30 më poshtë përkundrejt Përfituesit, në lidhje me mospajtueshmërinë e tij të mëparshme me kërkesat për dhënien e kompetencave menaxhuese.

Komisioni mund të përcaktojë pasoja të tjera nga një pezullim i tillë ose tërheqje në një vendim specifik Komisioni.

Vendimi i Komisionit mund të përcaktojë dispozita, përsa i përket pezullimit ose tërheqjes së dhënies së kompetencave menaxhuese në lidhje me njësitë ose autoritetet.

Neni 16

Decentralizimi pa kontroll *ex-ante* nga Komisioni

1. Decentralizimi pa kontroll *ex-ante* nga Komisioni do të jetë objektivi për zbatimin e të gjithë komponentëve IPA, ku asistenca zbatohet mbi një bazë decentralizimi në përputhje me nenin 5 më sipër. Koha e arritjes së këtij objektivi mund të ndryshojë në varësi të komponentit përkatës IPA.

2. Para heqjes së kontrolleve *ex-ante* të përcaktuar në vendimin e Komisionit për dhënien e menaxhimit, Komisioni do të sigurohet për funksionimin efektiv të menaxhimit dhe sistemit të kontrollit relevant, në përputhje me Komunitetin përkatës dhe rregullat kombëtare. Në veçanti, Komisioni do të monitorojë zbatimin, nga Përfituesi, të planit të detajuar që përfshihet në marrëveshjen financiare, e cila mund t'i referohet një dorëheqjeje fazore të tipave të ndryshëm të kontrolleve *ex-ante*. Komisioni do të marrë parasysh rezultatet e arritura nga Përfituesi në këtë kontekst, në veçanti në dhënien e asistencës dhe në procesin e negociatave.

Neni 17

Deklarimi i garancisë nga zyrtari kombëtar i autorizuar

1. Zyrtari kombëtar i autorizuar duhet të bëjë një deklaratë vjetore menaxhimi duke shpjeguar:

- përgjegjësinë e tij të plotë, në funksionin e tij si drejtues i Fondit Kombëtar, për menaxhimin financiar të fondeve të BE në (vendi) dhe për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë;

- përgjegjësinë e tij për funksionimin efektiv të menaxhimit dhe sistemit të kontrollit të IPA-s.

Kjo deklaratë menaxhimi do të marrë formën e deklaratë garancisë, që do të prezantohet në Komision çdo vit më 28 shkurt, për dijeni drejtuar zyrtarit përgjegjës akreditues.

2. Deklarata e garancisë do të mbështetet në mbikëqyrjen aktuale të zyrtarit kombëtar të autorizuar

të menaxhimit dhe sistemit të kontrollit gjatë gjithë vitit financiar.

3. Deklarata e garancisë do të hartohet sipas modelit në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje kuadër.

4. Nëse miratimet lidhur me funksionimin efektiv të menaxhimit dhe sistemit të kontrollit dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë të nevojshme në deklaratën e garancisë, nuk janë në dispozicion, zyrtari kombëtar i autorizuar do të informojë Komisionin, për dijeni zyrtarit përgjegjës akreditues, për arsyet dhe pasojat e mundshme, si dhe për veprimet që janë ndërmarrë për të përmirësuar situatën dhe për të mbrojtur interesat e Komunitetit.

Neni 18

Krijimi i raporteve dhe opinioneve nga autoriteti i auditimit dhe pasuar nga zyrtari kombëtar i autorizuar dhe Komisioni

1. Për funksionet e caktuara dhe përgjegjësitë e autoritetit të auditimit siç paraqiten në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje kuadër, autoriteti i auditimit do të krijojë në veçanti raportet dhe opinionet e mëposhtme:

a) një raport vjetor aktivitetit të auditit, sipas modelit në aneksin C të kësaj Marrëveshjeje kuadër;

b) një opinion vjetor auditi për menaxhimin dhe sistemin e kontrollit, sipas modelit në aneksin D të kësaj Marrëveshjeje kuadër;

c) një opinion auditi për deklarimin përfundimtar të shpenzimeve për përfundimin e një programi ose pjesëve të një programi sipas modelit në aneksin E të kësaj Marrëveshjeje kuadër.

2. Në vijim të marrjes së raportit vjetor të aktivitetit dhe opinionit vjetor të auditit të përmendur në paragrafin 1, zyrtari kombëtar i autorizuar:

a) do të vendosë, nëse kërkohet, ndonjë përmirësim në menaxhim dhe sisteme kontrolli, do të regjistrojë vendimet në këtë drejtim dhe do të sigurojë zbatimin në kohë të këtyre përmirësimeve;

b) do të bëjë ndonjë rregullim të nevojshëm për pagesë aplikimesh te Komisioni.

3. Komisioni mund të vendosë ose të marrë vetëveprim pasues në përgjigje të raporteve dhe opinioneve, për shembull duke iniciuar një procedurë korrigjimi financiar, ose t'i kërkojë Përfituesit të ndërmarrë masa, ndërsa informon zyrtarin kombëtar të autorizuar dhe zyrtarin përgjegjës akreditues për vendimin e tij.

SEKSIONI IV

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR ASISTENCËN FINANCIARE KOMUNITARE

Neni 19

Pranueshmëria e shpenzimit

Në rast menaxhimi të decentralizuar, pavarësisht akreditimeve nga zyrtari përgjegjës akreditues dhe zyrtari kombëtar i autorizuar, kontratat dhe shtesat e nënshkruara, shpenzimi i pësuar dhe pagesat e bëra nga autoritetet kombëtare nuk do të jetë i pranueshëm financimi sipas IPA-s para dhënies së menaxhimit nga Komisioni për strukturat dhe autoritetet e interesuara. Data e fundit për pranim shpenzimi do të përcaktohet në marrëveshjet financiare, ku të jetë e nevojshme.

Me qëllim derogimin nga paragrafi 1:

a) asistenca teknike për të mbështetur ngritjen e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit, mund të jetë e pranueshme para dhënies fillestare të menaxhimit, për shpenzimin e bërë pas 1 janarit 2007;

b) shpenzimi në vijim të hapjes së thirrjeve për propozime ose thirrjeve për tendera, mund të jetë gjithashtu i pranueshëm, nëse thirrja është hapur para dhënies fillestare të menaxhimit, duke qenë brenda afateve kohore të përcaktuar në një klauzolë rezervë për t'u futur në operacionet ose thirrjet përkatëse, dhe i nënshtrohet miratimit paraprak të dokumenteve të nevojshme nga Komisioni. Thirrjet për propozime ose thirrjet për tendera përkatës, mund të anulohen ose modifikohen në varësi të vendimit për dhënien e menaxhimit.

Shpenzimi i financuar sipas IPA-s nuk do t'i nënshtrohet ndonjë financimi tjetër, sipas buxhetit të

Komunitetit.

Përveç paragrafit 1 deri 3 më sipër, më shumë rregulla të hollësishme për pranueshmërinë e shpenzimit mund të jepen në marrëveshjet financiare ose marrëveshjet sektoriale.

Neni 20
Pronësia e interesit

Çdo interes i fituar për ndonjë komponent specifik llogarie në euro do të mbetet pronësi e Përfituesit. Interesi i gjeneruar nga financimi i një programi nga Komuniteti do t'i çohet ekskluzivisht atij programi, i konsideruar si një burim për Përfituesin në formën e një kontributi publik kombëtar dhe do t'i deklarohet Komisionit, në kohën e përfundimit final të programit.

Neni 21
Regjistrimi audit

Zyrtari kombëtar i autorizuar siguron që, i gjithë informacioni përkatës është i mundshëm të sigurojë në çdo kohë, në mënyrë të mjaftueshme një regjistrim audit të hollësishëm. Ky informacion do të përfshijë evidencë të dokumentuar të autorizimit të aplikimeve, të llogaritjes dhe pagesës së aplikimeve të tilla, si dhe të trajtimit të huave, garancive dhe borxheve.

Neni 22
Intensiteti i ndihmës dhe shkalla e kontributit komunitar

1. Kontributi i Komunitetit do të llogaritet në lidhje me shpenzimin e pranuar, siç përcaktohet në pjesën II të rregullores zbatuese IPA për çdo komponent të IPA-s.

2. Vendimet financiare që miratojnë programet vjetore ose shumëvjeçare për çdo komponent të IPA do të vendosin sasinë treguese maksimale të kontributit të Komunitetit dhe vlerën maksimale pasuese për çdo aks prioriteti.

SEKSIONI V
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM

Neni 23
Rregullat e prokurimit

1. Asistenca, sipas të gjithë komponentëve IPA, menaxhohet në përputhje me rregullat e ndihmës së jashtme që përmban rregullorja financiare. Këto rregulla nuk janë të zbatueshme për asistencat e zbatuara nën rregullimet e përkohshme të nenit 99 të rregullores zbatuese IPA, në lidhje me komponentin "Bashkëpunimi ndërkufitar" që i përket asaj pjese të programit që zbatohet në territorin e Shteteve Anëtare, përveçse kur Shtetet Anëtare pjesëmarrëse vendosin ndryshe.

2. Rezultatet e procedurave të tenderit publikohen sipas rregullave të paragrafit 1 më sipër dhe sipas specifikimeve të nenit 24(3) më poshtë.

3. Rregullat e pjesëmarrjes dhe origjinës të përcaktuara në nenin 19 të rregullores kuadër IPA praktikohen për të gjitha procedurat e dhënies së kontratave nën IPA-n.

4. Të gjitha kontratat e punës, furnizimeve dhe shërbimeve jepen dhe zbatohen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme, të cilat janë në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjet sektoriale ose financiare.

Neni 24
Publiciteti dhe fizibiliteti

Në rast menaxhimi të centralizuar ose të përbashkët, informacionet për programet dhe operacionet jepen nga Komisioni me ndihmën e KKIPA-s, sipas rastit. Në rast të menaxhimit të centralizuar dhe në të gjitha rastet për programet ose pjesë të programeve të komponentit të bashkëpunimit ndërkufitar jo të zbatuara nëpërmjet menaxhimit të përbashkët, Përfituesi, veçanërisht KKIPA, jep informacion dhe publikon programet dhe operacionet. Në rastin e menaxhimit të përbashkët, Shtetet Anëtare dhe Përfituesi japin informacione dhe publikojnë programet dhe operacionet. Informacioni iu adresohet qytetarëve dhe përfituesve, me qëllim nënvizimin e rolit të Komunitetit dhe sigurimin e transparencës.

Në rast menaxhimi të centralizuar, strukturat operuese janë përgjegjëse për organizimin e publikimit të listës së përfituesve përfundimtarë, emrat e operacioneve dhe shumën e fondeve të Komunitetit, të akorduara për operacionet me anë të dhënies së granteve, sipas mënyrës së mëposhtme:

a) Publikimi bëhet sipas një prezantimi standard, në faqen e internetit të Përfituesit në një vend të posaçëm dhe ku lehtësisht mund të ketë akses. Nëse ky publikim në internet është i pamundur, informacioni publikohet me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme, përfshirë fletoren zyrtare kombëtare.

b) Publikimi bëhet gjatë gjysmës së parë të vitit, pas mbylljes së vitit buxhetor, duke marrë si pikë referimi vitin kur fondet iu atribuan Përfituesit.

c) Përfituesi i komunikon Komisionit adresën e vendit të publikimit. Nëse informacioni është publikuar në mënyra të tjera, Përfituesi i jep Komisionit informacionet e detajuara për mjetin publik të përdorur.

d) Strukturat operuese duhet të bëjnë të mundur që Përfituesi përfundimtar të informohet se pranimi i financimit presupozon pranimin nga ana e tyre për t'u përfshirë në listën e Përfituesve që publikohet. Çfarëdo e dhënë personale e asaj liste përpunohet në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) nr.45/2001 të Parlamentit Europian dhe Këshillit të 18 dhjetorit 2000 për mbrojtjen e individëve, për sa i takon përpunimit të të dhënave personale nga institucionet dhe organizmat e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave[5], dhe duke respektuar kërkesat e përcaktuara të sigurisë.

Në rast menaxhimi të decentralizuar, organet përgjegjëse përgatisin një njoftim për dhënie kontrate, sapo kontrata të jetë nënshkruar, dhe ia dërgojnë Komisionit për publikim. Njoftimi i dhënies së kontratës, gjithashtu mund të publikohet nga Përfituesi në publikimet e caktuara kombëtare.

Komisioni dhe autoriteteve përkatëse kombëtare, rajonale apo vendore të Përfituesit, bien dakord për një sërë aktivitetesh koherente në mënyrë që të ofrohet dhe publikohet informacion në (vendi) për asistencën në kuadrin e IPA. Procedurat për zbatimin e aktiviteteve të tilla specifikohen në marrëveshjet sektoriale ose financiare.

Zbatimi i aktiviteteve referuar në paragrafin 4 janë përgjegjësi e Përfituesve përfundimtarë dhe mund të financohen nga shuma e akorduar nga programet përkatëse dhe operacionet.

Neni 25

Dhënia e lehtësirave për zbatimin e programeve dhe ekzekutimin e kontratave

1. Në mënyrë që të sigurohet zbatimi efikas i programeve në kuadrin e IPA-s, Përfituesi merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar:

a) se në rast procedurash tenderimi për shërbime, furnizime apo punime, personat fizikë dhe juridikë, që kanë të drejtë të marrin pjesë në procedura tenderimi sipas nenit 23 më lart, kanë të drejtën e qëndrimit apo rezidencës së përkohshme, kur rëndësia e kontratës e kërkon një gjë të tillë. Kjo e drejtë fitohet, vetëm pasi ftesa për tender është lançuar dhe gëzohet edhe nga stafi teknik i nevojshëm për të bërë studime dhe masa të tjera përgatitore për organizimin e tenderave. Kjo e drejtë skadon një muaj pas vendimit për dhënien e kontratës;

b) se personeli që merr pjesë në aktivitete të financuara nga Komisioni dhe pjesëtarë të afërt të familjes së tyre përfitojnë avantazhe, privilegje apo përjashtime jo më pak të favorshme sesa stafi ndërkombëtar i punësuar në (vendi), sipas çfarëdo marrëveshjeje tjetër dypalëshe apo shumëpalëshe, apo akordeve për asistencë dhe bashkëpunim teknik;

c) se personeli që merr pjesë në aktivitetet e financuara nga Komisioni dhe pjesëtarët e afërt të familjes së tyre lejohen të hyjnë në (vendi), të vendosen fizikisht në (vendi), të punojnë dhe të largohen nga (vendi), siç përcaktohet nga natyra e kësaj kontrate;

d) dhënien e të gjitha lejeve të nevojshme për importimin e mallrave, sidomos pajisjeve profesionale, që kërkohen për ekzekutimin e kontratës në fjalë, subjekt i ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregulloreve të Përfituesit;

[5] FZ L 8, 12 janar 2001, faqe 1.

e) se importet në kuadrin e IPA-s përjashtohen nga tarifat doganore, tarifat e importit dhe tatime fiskale të tjera;

f) dhënien e lejeve të nevojshme për rieksportimin e mallrave të mësipërme, me të përfunduar ekzekutimi i plotë i kontratës në fjalë;

g) dhënien e autorizimeve për importimin apo blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate dhe zbatimin e rregullave të kontrollit kombëtar mbi shkëmbimin në mënyrë jodiskriminuese ndaj kontraktorëve, pavarësisht kombësisë së tyre apo vendit ku operojnë;

h) dhënien e të gjitha lejeve të nevojshme për kthimin e fondeve të marra për aktivitetet e financuara nga IPA, në përputhje me rregullat e kontrollit mbi shkëmbimin e huaj që janë në fuqi në (vendi).

2. Përfituesi siguron bashkëpunim të plotë mes të gjitha autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, Përfituesi garanton akses në shoqëritë shtetërore dhe institucione të tjera shtetërore që janë të përfshira ose janë të nevojshme në zbatimin e programit apo ekzekutimin e kontratës.

Neni 26

Rregulla për taksat, tarifat doganore dhe tatime të tjera fiskale

1. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financiare, tarifat doganore, taksat e importit apo tatime të tjera me efekt të barasvlefshëm, nuk janë të zbatueshme për IPA-n.

2. Zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Tarifat doganore, tarifat e importit, taksat apo tatime fiskale të tjera me efekt të barasvlefshëm, në rastin e importimit të furnizimeve në kuadrin e një kontrate të financuar nga Komuniteti, nuk janë të zbatueshme për IPA-n. Këto importe kalojnë nga pika e hyrjes në (vendi) dhe i dorëzohen kontraktorit, siç kërkohet nga dispozitat e kontratës për përdorim të menjëhershëm nga ana e tij sipas zbatimit normal të kontratës, pavarësisht çfarëdo vonese apo mosmarrëveshjeje për tarifat apo taksat e mësipërme.

b) Kontratat e financuara nga Komuniteti për shërbime, furnizime apo punime që kryhen nga kontraktorët e regjistruar në (vendi) ose nga kontraktorët e jashtëm, në (vendi) nuk janë subjekt i TVSH-së, stampës dokumentuese, tarifave regjistruese apo pagesave fiskale me efekt të barasvlefshëm, pavarësisht nëse këto tarifa ekzistojnë ose pritet të vendosen. Kontraktorët e KE-së përjashtohen nga TVSH për shërbimet e dhëna, mallrat e furnizuara dhe/ose punimet e kryera në kuadrin e kontratave të KE-së, me të drejtën e kontraktorëve për të kompensuar apo zbritur TVSH e paguar në lidhje me shërbimet e dhëna, mallrat e furnizuara dhe/ose punimet e ekzekutuara kundrejt çfarëdo TVSH-je të mbledhur prej tyre për cilindo nga transaksionet e tyre. Nëse kontraktorët e KE-së nuk arrijnë të shfrytëzojnë këtë mundësi, ata do të arrijnë të marrin rimbursimin e TVSH-së drejtpërdrejt nga autoritetet tatimore, sapo të paraqesin një kërkesë me shkrim të shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm në kuadrin e ligjit kombëtar/vendor për rimbursimin dhe një kopje të noterizuar të kontratës me KE-në.

Për qëllimet e Marrëveshjes kuadër, termi “Kontraktor i KE-” interpretohet si një person fizik apo juridik, që ofron shërbime ose furnizon me mallra, ose kryen punime, ose ekzekuton një grant të një kontrate të KE-së. Termi “Kontraktor i KE-së” përfshin edhe këshilltarët e para-anëtarësimit, të njohur gjithashtu si këshilltarë rezidentë binjakëzimi, si dhe ekspertët e përfshirë në marrëveshjen apo kontratën binjakëzuese. Termi “Kontratë e KE-së” nënkupton çdo dokument ligjërisht detyrues nëpërmjet të cilit një aktivitet financohet nga IPA dhe që nënshkruhet nga KE ose Përfituesi.

Të paktën të njëjtat privilegje procedurale përfitojnë këta kontraktorë, ashtu si kontraktorët e tjerë në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe apo marrëveshje për asistencë dhe bashkëpunim teknik.

c) Fitimi dhe/ose të ardhurat që rrjedhin nga kontratat e KE-së janë të tatueshme në (vendi) sipas sistemit tatimor kombëtar/vendor. Megjithatë, personat fizikë dhe juridikë, përfshirë stafin e huaj të transferuar nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian ose vende të tjera në kuadrin e IPA-s dhe që ekzekutojnë kontrata të financuara nga Komuniteti, përjashtohen nga këto taksa në (vendi).

d) Sendet personale apo shtëpiake të importuara për përdorim personal nga ana e personave fizikë (dhe anëtarë të familjeve të tyre), përveç atyre të rekrutuar në lokalitetin vendor, që angazhohen për detyra të përcaktuara në kontrata bashkëpunimi teknik, përjashtohen nga tarifat doganore, tarifat e importit dhe taksa të tjera fiskale me efekt të barasvlefshëm, me kusht që këto sende personale apo shtëpiake të rieksportohen ose transferohen në shtet, në përputhje me rregulloret në fuqi në (vendi) pas përfundimit të kontratës.

Neni 27

Mbikëqyrja, kontrolli dhe auditimi nga Komisioni dhe Gjykata Europiane e Kontrollorëve Financiarë

1. Të gjitha marrëveshjet financiare dhe të gjitha programet e tyre dhe kontratat përkatëse janë objekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar nga ana e Komisionit, përfshirë edhe Zyrën Europiane Antimashtrim (OLAF) dhe audite nga Gjykata Europiane e Auditorëve. Këtu përfshihet e drejta e Delegacionit të Komisionit në (vendi) për të ndërmarrë masa si për shembull verifikimi *ex-ante* i tenderimit dhe kontraktimit të kryer nga strukturat përkatëse operuese, për sa kohë që kontrolli *ex-ante* bëhet sipas nenit 16 më sipër. Agjentët përkatës të autorizuar apo përfaqësuesit e Komisionit dhe të OLAF kanë të drejtë të kryejnë çfarëdo verifikimi teknik apo financiar që Komisioni apo OLAF e konsideron të nevojshëm për ndjekjen e zbatimit të një programi, përfshirë vizitat në vend dhe mjediset ku zbatohen aktivitetet e financuara nga Komuniteti. Komisioni i jep autoriteteve kombëtare përkatëse njoftim paraprak për këto misione.

2. Përfituesi i dorëzon të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara, përfshirë të dhënat kompjuterike dhe merr të gjitha masat e përshtatshme për t'i lehtësuar punën personave të udhëzuar për kryerjen e auditeve apo inspektimeve.

3. Përfituesi duhet të mbajë të dhëna dhe llogari të mjaftueshme për të evidentuar shërbimet, furnizimet, punimet dhe grantet e financuara në kuadrin e Marrëveshjes Financiare përkatëse sipas procedurave të qëndrueshme kontabiliteti. Përfituesi gjithashtu duhet të bëjë të mundur që agjentët dhe përfaqësuesit e Komisionit, përfshirë ato të OLAF, të kenë të drejtën të inspektojnë të gjithë dokumentacionin dhe llogaritë që i përkasin gjërave të financuara nga marrëveshja financiare përkatëse dhe të asistojnë në Gjykatën Europiane të Kontrollorëve Financiarë që të kryejnë audite në lidhje me përdorimin e fondeve të Komunitetit.

4. Me qëllim garantimin e mbrojtjes efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni përfshi OLAF, mund të kryejë kontrolle pa paralajmërim dhe inspektime sipas rregullores së Këshillit (KE, Euroatom) 2185/1996 të 11 nëntorit 1996 (6). Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të caktuara nga Përfituesi, i cili do të informohet në kohën e duhur për qëllimin, synimet dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, kështu që ato mund të sigurojnë të gjithë ndihmën e kërkuar. Përfituesi duhet të identifikojë një shërbim, i cili do të ndihmojë me kërkesë të OLAF-it në kryerjen e kontrolleve sipas rregullores së Këshillit (KE, Euroatom) nr.2185/1996 të 11 nëntorit 2006. Në qoftë se Përfituesi dëshiron, kontrollet pa paralajmërim dhe inspektimet mund të kryhen së bashku me to. Kur pjesëmarrësit në aktivitete të financuara nga Komuniteti pengojnë kontrollet e paralajmëruara dhe inspektimet, Përfituesi, duke vepruar sipas rregullave kombëtare, do t'u ofrojë inspektorëve të Komisionit/OLAF ndihmën e nevojshme që t'i lejojnë ata të kryejnë detyrën e tyre duke bërë kontrollet në vend dhe inspektimet.

Komisioni/OLAF do t'i raportojë sa më shpejt të jetë e mundur Përfituesit ndonjë fakt ose dyshim lidhur me parregullsi, të cilat janë vënë re gjatë zhvillimit të kontrolleve në vend dhe inspektimeve. Në çdo rast Komisioni/OLAF do të informojë autoritetet e lartpërmendura për rezultatet e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve .

5. Kontrollet dhe auditet e përshkruara më lart janë të zbatueshme për të gjithë kontraktorët dhe nënkontraktorët që kanë marrë fonde komunitare, përfshirë këtu të gjithë informacionin përkatës në dokumentet e fondit kombëtar të Përfituesit në lidhje me kontributin kombëtar.

6. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Europiane të Auditorëve, llogaritë dhe operacionet e fondit kombëtar, dhe aty ku është e zbatueshme, strukturat operuese mund të kontrollohen sipas dëshirës së Komisionit nga vetë Komisioni ose kontrollorë financiarë të jashtëm të caktuar nga Komisioni.

Neni 28

Parandalimi i parregullsive dhe mashtrimit, masat kundër korrupsionit

Përfituesi siguron hetim dhe trajtim efikas të rasteve të dyshuara për mashtrim apo parregullsi dhe siguron funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi të barasvlefshëm me atë të parashikuar në rregulloren e Komisionit (KE) nr.1828/2006 të 8 dhjetorit 2006 (7). Në rastin e mashtrimeve dhe parregullsive të dyshuara, Komisioni duhet të informohet pa vonesë.

Gjithashtu, Përfituesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar apo

[6] FZ L 292, 15 nëntor 1996, faqe 2.
[7] FZ L 371, 27 dhjetor 2006, faqe 4.

kundërshtuar çdo praktikë aktive apo pasive korrupsioni në cilëndo fazë të procedurës tenderuese apo procedurës së dhënies së grantit ose gjatë zbatimit të kontratave korresponduese.

Përfituesi, përfshirë personelin përgjegjës për zbatimin e detyrave të aktiviteteve të financuara nga Komuniteti, merr përsipër të marrë çdo lloj mase që është e nevojshme për të shmangur ndonjë rrezik konflikti interesash dhe duhet të informojë menjëherë Komisionin për ndonjë konflikt të tillë interesash ose ndonjë situatë të ngjashme që mund të çojë në një konflikt të tillë.

Zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) Parregullsi nënkupton çfarëdo shkelje të një dispozite të rregullave të zbatueshme dhe kontratave që rezulton nga një akt ose një mosveprim nga një operator ekonomik që ka ose do të kishte efektin e cenimit të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Europian, duke ngarkuar një shpenzim të pajustifikuar në buxhetin e përgjithshëm.

b) Mashtrim nënkupton çdo akt të qëllimshëm apo mosveprim për: përdorim apo paraqitje deklaratash apo dokumentesh false, të pasakta apo të mangëta, që ka për efekt përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose buxheteve të menaxhuara në emër të Komuniteteve Europiane; moszbulimin e informacionit për shkeljen e një detyrimi specifik me të njëjtin efekt, keqpërdorimin e fondeve të tilla për qëllime të tjera nga qëllimet origjinale për të cilat janë akorduar.

c) Korrupsion aktiv nënkupton një veprim të qëllimshëm nga kushdo që premton ose kap, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, një avantazh të çfarëdo lloji te një zyrtar për vete ose për një palë të tretë për të, që të veprojë ose të mosveprojë në përputhje me detyrën e tij, ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke qenë në shkelje me detyrat zyrtare në një mënyrë që cenon ose ka gjasa të cenojë interesat financiare të Komuniteteve Europiane.

d) Korrupsion pasiv nënkupton veprim të qëllimshëm të një zyrtari, i cili drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi kërkon ose merr avantazhe të çfarëdo lloji për vete apo palë të treta, ose pranon premtimin për një avantazh të tillë për të vepruar ose mosvepruar sipas detyrave të tij, ose ushtrimin e funksioneve që përbën shkelje të detyrave zyrtare në një mënyrë që cenon ose ka gjasa të cenojë interesat financiare të Komuniteteve Europiane.

Neni 29

Rikuperimi i fondeve në rast parregullsish ose mashtrimi

1. Çdo rast i vërtetuar për parregullsi ose mashtrim në çfarëdo kohe gjatë zbatimit të asistencës në kuadrin e IPA-s ose si rezultat i një auditi, çon në rikuperimin e fondeve nga Përfituesi te Komuniteti.

2. Zyrtari kombëtar i autorizuar bën rikuperimin e kontributit komunitar që i paguhet Përfituesit nga ata që kryejnë parregullsinë, mashtrimin, korrupsionin apo përfituan prej tij, në përputhje me procedurat rikuperuese kombëtare. Edhe nëse zyrtari kombëtar i autorizuar mund të mos arrijë të rikuperojë të gjithë pjesën e fondeve, Komuniteti ka të drejtë të kërkojë kthimin e fondeve nga ana e Përfituesit.

Neni 30

Korrigjime financiare

Në rast menaxhimi të decentralizuar, me qëllim për t'u siguruar që fondet janë përdorur në përputhje me rregullat zbatuese, Komisioni do të zbatojë procedurat e qartësimit të llogarive ose mekanizmat e korrigjimit financiar sipas nenit 53b (4) dhe 53c (2) të rregullores financiare dhe siç tregohet hollësisht në marrëveshjet sektoriale ose marrëveshjet financiare.

Një korrigjim financiar mund të rrjedhë si pasojë ose:

e identifikimit të një parregullsie specifike, që përfshin mashtrimin;

e identifikimit të një dobësie ose deficiti në menaxhimin dhe sistemet e kontrollit të Përfituesit.

Nëse Komisioni mëson se shpenzimi, sipas programeve të mbuluara nga IPA, ka ndodhur në një mënyrë që ka shkelur rregullat e zbatueshme, ai do të vendosë çfarë shume do të përjashtohet nga financimi komunitar.

Llogaritja dhe bërja e ndonjë korrigjimi të tillë, si dhe rigjenerimet përkatëse do të bëhen nga Komisioni, duke ndjekur kriteret dhe procedurat që përcaktohen në nenet 31, 32 dhe 33 më poshtë.

Dispozitat për korrigjimet financiare, të cilat janë vendosur në marrëveshjet sektoriale ose marrëveshjet financiare do të zbatohen përveç kësaj Marrëveshjeje kuadër.

Neni 31
Rregullimet financiare

Në rastin e menaxhimit të decentralizuar zyrtari kombëtar i autorizuar, i cili mban në fillim përgjegjësinë për të hetuar parregullsitë, do të bëjë rregullimet financiare atje ku parregullsitë ose pakujdesitë janë zbuluar në operacionet, ose programet operuese, duke anuluar të gjithë ose pjesë të kontributit komunitar të operacioneve ose programeve operuese përkatëse. Zyrtari kombëtar i autorizuar do të marrë parasysh natyrën dhe seriozitetin e parregullsive, si dhe humbjet financiare të kontributit komunitar.

Neni 32
Kriteret për korrigjime financiare

1. Komisioni mund të bëjë korrigjime financiare, duke anuluar të gjithë ose pjesë të kontributit komunitar për një program, në situatat e referuara në nenin 30 (2) më sipër.

2. Nëse identifikohen raste të veçanta parregullsie, Komisioni do të marrë parasysh natyrën sistematike të parregullsisë për të përcaktuar, nëse korrigjimet tarifë fikse ose korrigjime të përpikta, ose korrigjimet e mbështetura në një ekstrapolim të zbulimeve, duhet të zbatohen. Për sa i përket komponentit të zhvillimit rural, kriteret për korrigjimet financiare janë dhënë në marrëveshjet financiare ose marrëveshjet sektoriale.

3. Kur vendoset shuma e një korrigjimi, Komisioni do të marrë parasysh natyrën dhe seriozitetin e parregullsisë dhe/ose shtrirjen dhe implikimet financiare të dobësive ose deficiteve të konstatuara në sistemin e kontrollit dhe menaxhimit në programin përkatës.

Neni 33
Procedura për korrigjimet financiare

1. Para marrjes së një vendimi për një korrigjim financiar, Komisioni do të informojë zyrtarin kombëtar të autorizuar për konkluzionet e tij të përkohshme dhe do të kërkojë komentet e tij brenda dy muajve.

Nëse Komisioni propozon një korrigjim financiar mbi bazë ekstrapolimi ose mbi një tarifë fikse, Përfituesit do t'i jepet rasti të kontrollojë shtrirjen aktuale të parregullsisë, nëpërmjet një shqyrtimi të dokumentacionit përkatës. Në marrëveshje me Komisionin, Përfituesi mund të kufizojë sferën e këtij shqyrtimi deri në një raport të përshtatshëm ose model të dokumentacionit përkatës. Përveç se në rastet e justifikuara siç duhet, koha e lejuar për këtë ekzaminim nuk do të tejkalojë një periudhë prej dy muajsh pas periudhës dymujore të referuar në nënparagrafin e parë.

2. Komisioni do të marrë në konsideratë çdo tregues të siguruar nga Përfituesi brenda afatit të përmendur në paragrafin 1.

3. Komisioni do të përpiqet të marrë një vendim për korrigjim financiar brenda gjashtë muajve pas hapjes së procedurës, siç tregohet në paragrafin 1.

Neni 34
Shlyerja

1. Çfarëdo shlyerjeje për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian kryhet para datës së treguar në mandatin për kthimin e parave, të përgatitur në përputhje me nenin 72 të rregullores financiare. Dita e caktuar është dita e fundit e muajit të dytë pas lëshimit të mandatit.

2. Çfarëdo vonese në kthimin e parave shkakton ngarkimin me kamatë për pagesë të vonuar, e cila fillon nga data e caktuar deri në datën kur bëhet pagesa. Interesi i kësaj kamate është 1.5% pikë mbi interesin e aplikuar nga Banka Qendrore Europiane në operacionet e saj kryesore rifinancuese në ditën e parë të muajit në të cilin bie data e caktuar.

Neni 35

Ripërdorimi i kontributit komunitar

1. Burimet nga kontributi i Komunitetit, të anuluara pas korrigjimeve financiare, i paguhen buxhetit komunitar bashkë me interesat përkatëse.

2. Kontributi i anuluar ose i rikuperuar në përputhje me nenin 31 lart, mund të mos ripërdoren për operacionin ose operacionet që ishin objekt i rikuperimit të parave apo korrigjimit, ashtu edhe kur rikuperimi ose korrigjimi është bërë për një parregullsi sistematike, për operacione ekzistuese brenda të gjitha ose një pjesë të akseve prioritare në të cilat ka ndodhur parregullsia.

Neni 36

Monitorimi në rastin e menaxhimit të decentralizuar, komitetet monitoruese

1. Në rastin e menaxhimit të decentralizuar, Përfituesi brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së parë financuese, duhet të ngrejë një komitet monitorues IPA, në marrëveshje me Komisionin, për të siguruar koherencë dhe bashkërendim në zbatimin e komponentëve të IPA-s.

2. Komiteti monitorues IPA asistohet nga komitetet monitoruese sektoriale të ngritura në kuadrin e komponentëve IPA. Ata bashkëpunojnë për programet apo komponentët. Kur është me vend, në përbërje mund të ketë edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Rregulla më të detajuara jepen në marrëveshjet financuese apo marrëveshjet sektoriale.

3. Komiteti monitorues IPA, duhet të bindet për efikasitetin e përgjithshëm, cilësinë dhe koherencën e zbatimit të të gjitha programeve dhe operacioneve drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuar në dokumentet e planifikimit tregues shumëvjeçar dhe në marrëveshjet financiare:

a) Komiteti monitorues IPA, mund t'i paraqesë propozime Komisionit, KKIPA-s dhe zyrtarëve kombëtarë të autorizuar për çdo veprim, për të garantuar koherencën dhe bashkërendimin ndërmjet programeve dhe operacioneve të zbatuara nën komponentët e ndryshëm, si edhe për çfarëdo mase korrigjuese ndërkomponent që nevojiten për arritjen e objektivave kryesore të asistencës së dhënë dhe për të rritur efikasitetin e përgjithshëm. Gjithashtu, ky komitet mund t'i paraqesë propozime komitetit/eve sektoriale përkatëse për të marrë vendime për masa korrigjuese, për të siguruar arritjen e objektivave të programit dhe rritjen e efikasitetit të asistencës së dhënë në kuadrin e programeve apo komponentit/ëve IPA;

b) Komiteti monitorues IPA, miraton rregulloren e brendshme në përputhje me një mandat të komitetit monitorues të përcaktuar nga Komisioni dhe brenda kuadrit institucional, ligjor dhe financiar të (vendi);

c) Dispozitat e mëposhtme aplikohen, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në mandatin e komitetit monitorues të përcaktuar nga Komisioni:

aa) në përbërjen e komitetit monitorues IPA bëjnë pjesë edhe përfaqësues të Komisionit, KKIPA, zyrtari kombëtar i autorizuar, përfaqësues të strukturave operuese dhe koordinatori strategjik, kur çmohet e arsyeshme;

bb) një përfaqësues i Komisionit dhe KKIPA bashkëkryesojnë takimet e komitetit monitorues IPA.

Komiteti monitorues IPA mblidhet të paktën një herë në vit. Takime të ndërmjetme mund të organizohen në bazë tematikash.

Neni 37

Monitorimi në rastin e menaxhimit të centralizuar dhe të përbashkët

Në rast të menaxhimit të centralizuar dhe të përbashkët, Komisioni mund të ndërmarrë çfarëdo veprimi që e çmon të nevojshëm për monitorimin e programeve në fjalë. Në rastin e menaxhimeve të përbashkëta, këto veprime mund të kryhen bashkërisht me organizatën/at ndërkombëtare përkatëse.

Neni 38

Raportet vjetore dhe përfundimtare për zbatimin

1. Strukturat operuese hartojnë një raport vjetor sektorial dhe një raport përfundimtar sektorial mbi zbatimin e programeve, për të cilat janë përgjegjëse, në përputhje me procedurat e përcaktuara për secilin komponent IPA në pjesën II të rregullores zbatuese të IPA-s.

2. Raportet vjetore sektoriale për zbatimin duhet të mbulojnë vitin financiar. Raportet përfundimtare sektoriale për zbatimin duhet të mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit dhe mund të

përfshijnë raportin e fundit vjetor sektorial.

Raportet e referuara në paragrafin 1 dërgohen te KKIPA, ZKA dhe Komisioni, pasi shqyrtohen nga komitetet monitoruese sektoriale.

3. Mbi bazën e raporteve të referuara në paragrafin 1, KKIPA i dërgon Komisionit dhe zyrtari kombëtar i autorizuar, pas shqyrtimit nga ana e komitetit monitorues të IPA, raportet vjetore dhe përfundimtare për zbatimin e asistencës në kuadrin e rregullores IPA.

4. Raporti vjetor për zbatimin, i referuar në paragrafin 3, që do dërgohet më 31 gusht të çdo viti duke filluar për herë të parë nga viti 2008, duhet të sintetizojë raportet e ndryshme vjetore sektoriale të përgatitura nën komponentët e ndryshëm dhe përmban informacion për:

a) progresin e bërë në zbatimin e asistencës komunitare, në lidhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentin e planifikimit tregues shumëvjeçar dhe programet e ndryshme;

b) zbatimin financiar të asistencës komunitare.

5. Raporti përfundimtar për zbatimin, siç referohet në paragrafin 3, duhet të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit dhe mund të përfshijë raportin e fundit vjetor të përmendur në paragrafin 4.

Neni 39

Mbyllja e programeve nën menaxhimin e decentralizuar

1. Pasi Komisioni merr aplikimin për pagesën përfundimtare nga ana e Përfituesit, një program çmohet i mbyllur sapo ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme:

pagimi i bilancit përfundimtar nga ana e Komisionit;

lëshimi i një mandati për rikuperim parash nga ana e Komisionit;

kthimi i shumës së caktuar nga ana e Komisionit.

2. Mbyllja e një programi nuk cenon të drejtën e Komisionit për të ndërmarrë korrigjime financiare në një fazë të mëvonshme.

3. Mbyllja e një programi nuk ndikon në detyrimet e Përfituesit për të vazhduar mbajtjen e dokumenteve përkatëse.

4. Në shtesë të paragrafit 1 dhe 3 më lart, rregulla më të detajuara për mbylljen e programeve mund të renditen në marrëveshjet financiare ose marrëveshjet sektoriale.

Neni 40

Mbyllja e programeve nën menaxhimin e centralizuar dhe të përbashkët

Programi mbyllet, pasi të mbyllen të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga ky program.

Pasi merret aplikimi i fundit për pagesë, një kontratë apo një grant çmohet i mbyllur sapo ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme:

paguhet shuma e fundit, që i takon nga Komisioni;

lëshohet mandati i rikuperimit nga ana e Komisionit, pas marrjes së faturës së aplikimit të pagesës së fundit;

kthimi i shumës së caktuar nga ana e Komisionit.

Mbyllja e programit nuk cenon të drejtën e Komisionit për të ndërmarrë korrigjime financiare në një fazë të mëvonshme.

Në shtesë të paragrafit 1 dhe 3 më lart, rregulla më të detajuara për mbylljen e programeve mund të renditen në marrëveshjet financiare ose marrëveshjet sektoriale.

SEKSIONI VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Konsultimi

1. Çdo çështje në lidhje me ekzekutimin apo interpretimin e Marrëveshjes kuadër është objekt konsultimi ndërmjet Palëve Kontraktuese që rezulton, kur është e nevojshme, në amendim të kësaj Marrëveshjeje kuadër.

2. Kur nuk arrihet përmbushja e një detyrimi të përcaktuar në Marrëveshjen kuadër që nuk ka qenë objekt i masave riparuese në kohën e duhur, Komisioni mund të pezullojë financimin e aktiviteteve nën IPA-n pas konsultimit me Përfituesin.

3. Përfituesi mund të heqë dorë nga zbatimi i plotë apo i pjesshëm i aktiviteteve nën IPA-n. Palët Kontraktuese me anë të shkëmbimit të letrave përcaktojnë detajet e kësaj dorëheqjeje.

Neni 42

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, arbitrimi

1. Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi, operimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Kuadër, në cilindo nga të gjithë nivelet e pjesëmarrjes, zgjidhen miqësisht nëpërmjet konsultimeve të përcaktuara në nenin 41.

2. Në rast se nuk arrihet kjo zgjidhje miqësore, secila nga Palët Kontraktuese mund ta paraqesë çështjen për arbitrim në përputhje me rregullat opsionale arbitruese të Gjykatës së Përhershme të Arbitrimit për Organizatat Ndërkombëtare dhe Shtetet, që kanë qenë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje kuadër.

3. Gjuha që përdoret në procedimet e arbitrimit, është anglishtja. Autoritet përgjegjës është Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrimit pas një kërkese me shkrim e dorëzuar nga cilado prej Palëve Kontraktuese. Vendimi i arbitruesit është detyrues për të gjitha palët dhe nuk lejohet apelim i tij.

Neni 43

Mosmarrëveshjet me palët e treta

1. Pa cenuar juridiksionin e gjykatës që është e përcaktuar në kontratë si kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet palëve nga kjo kontratë, Komuniteti Europian gëzon në territorin e (vendi) imunitet nga paditë apo procedimet ligjore për sa i përket çfarëdo mosmarrëveshjeje ndërmjet Komunitetit Europian dhe/ose Përfituesit dhe një pale të tretë, ose ndërmjet palëve të treta, e cila drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt lidhet me dhënien e asistencës komunitare Përfituesit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje kuadër, me përjashtim të ndonjë rasti kur Komuniteti Europian ka dhënë pëlqimin për të hequr dorë nga një pjesë e imunitetit.

2. Përfituesi, në çfarëdo procedimi ligjor apo administrativ në gjykatë, tribunal ose instancë administrative në (vendi) mbron këtë imunitet dhe pozicioni që mban merr parasysh interesat e Komunitetit Europian. Kur është e nevojshme, Përfituesi dhe Komisioni Europian mund të konsultohen për pozicionin që duan të marrin.

Neni 44

Njoftime

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje kuadër bëhet me shkrim dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe të dorëzohet si dokument origjinal ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje Kuadër dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komisionin:	Për Përfituesin:
Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit	Adresa postare
Adresa postare	Faks
Faks	

Neni 45

Anekset

Anekset konsiderohen pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje kuadër.

Neni 46

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje kuadër hyn në fuqi ditën kur Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën me shkrim për miratimin e saj, në përputhje me legjislacionin e brendshëm ekzistues ose procedurën e secilës prej palëve.

Neni 47
Amendimi

Çdo amendim i rënë dakord nga Palët Kontraktuese bëhet me shkrim dhe është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Ky amendim hyn në fuqi në datën e caktuar nga Palët Kontraktuese.

Neni 48
Përfundimi i kontratës

1. Kjo Marrëveshje kuadër vazhdon të jetë në fuqi për një periudhë të pacaktuar, në rastet kur nuk përfundon me njoftim të shkruar nga njëra prej Palëve Kontraktuese.

2. Në përfundim të kësaj Marrëveshjeje kuadër, çfarëdo asistence që është në ekzekutim e sipër, vazhdon deri në përfundimin e saj në përputhje me këtë Marrëveshje kuadër dhe çfarëdo marrëveshjeje sektoriale dhe marrëveshjeje financiare.

Neni 49
Gjuha

Kjo Marrëveshje kuadër përgatitet në dublikatë në gjuhën angleze.

E nënshkruar, për dhe në emër të Qeverisë së (vendi),
në
nga ……

E firmosur, për dhe në emër të Komisionit,
në
nga ……

ANEKSI A

AKORDIMI I FUNKSIONEVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË PËRBASHKËTA TE STRUKTURAT, AUTORITETET DHE ORGANET NË PËRPUTHJE ME NENIN 10 TË MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT DHE PËRFITUESIT MË (DATË)

Shënim paraprak;

Kjo listë tregon funksionet kryesore dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse. Nuk duhet të konsiderohet sikur mbulon gjithçka. Ajo plotëson pjesën thelbësore të kësaj Marrëveshjeje kuadër.

1. Zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA):

ZPA caktohet nga Përfituesi. Ai është një zyrtar i lartë i qeverisë ose i administratës shtetërore të (vendi).

ZPA është përgjegjës për dhënien, monitorimin, pezullimin apo bllokimin e akreditimit të zyrtari kombëtar i autorizuar (ZKA) në dy aspekte:

si kryetar i fondit kombëtar që ka përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në (vendi) dhe është përgjegjës që transaksionet nën këtë marrëveshje të jenë të ligjshme dhe të rregullta;

për sa i përket aftësisë së ZKA për të përmbushur përgjegjësitë për funksionim efikas të menaxhimit dhe sistemeve kontrolluese nën IPA.

Akreditimi i ZKA mbulon edhe fondit kombëtar (FK).

ZPA njofton Komisionin për akreditimin e ZKA-së dhe duhet të informojë Komisionin për çdo ndryshim në lidhje me akreditimin e ZKA-së. Kjo nënkupton që informacioni përkatës i kërkuar nga

Komisioni, duhet t'i dërgohet Komisionit.

c) Përpara akreditimit të ZKA, ZPA duhet të sigurohet që janë përmbushur kërkesat e zbatueshme të nenit 11 të rregullave zbatuese IPA. Kjo nënkupton verifikimin e përputhshmërisë së sistemit menaxhues dhe kontrollues të ngritur nga Përfituesi për kontrolle efikase të paktën në zonat e përcaktuara në aneksin e rregullores zbatuese IPA (kriteret e akreditimit). Ky aneks siguron kërkesat e mëposhtme:

Respektimin e mjedisit (ambientet dhe administratës së organizatës dhe stafin), që përfshin politikat e etikës dhe integritetit, menaxhimin dhe raportimin e parregullsive, planifikimin e stafit, rekrutimin, trajnimin dhe vlerësimin, përfshi postmenaxhim, funksione sensitive dhe shmangien e konflikteve të interesit, vendosjen e kuadrove ligjore për organizmat dhe individët, vendosjen zyrtare të kërkesëllogarisë, përgjegjësinë, përgjegjësinë e deleguar dhe çdo kompetence përkatëse për të gjitha detyrat dhe pozicionet në organizatë).

Planifikimin dhe menaxhimin e riskut që përfshin evidentimin e riskut, vlerësimin dhe menaxhimin, vendosjen e objektivave dhe akordimin e burimeve për këto objektiva dhe planifikimin e procesit zbatues.

Aktivitete kontrolli (zbatimin e ndërhyrjeve) që përfshin procedurat verifikuese, procedurat e mbikëqyrjes së detyrave të deleguara vartësve, përfshirë deklaratat vjetore të sigurimit nga aktorët vartës, rregullat për secilin lloj prokurimi dhe thirrjet për propozim, procedura përfshirë listat ose secilin hap të prokurimeve dhe thirrjeve për propozim, rregullat dhe procedurat për publicitetin, procedurat e pagesave, procedurat për monitorimin e shpërndarjes së bashkëfinancimit, procedurat buxhetore për të garantuar disponimin e fondeve, procedurat për vazhdimin e operacioneve, procedurat e kontabilitetit, procedurat e rakordimit, raportimin e rasteve përjashtuese, veçanërisht raportimin e përjashtimeve nga procedurat normale të miratuara në nivelin përkatës, përjashtime të pamiratuara dhe dështime kontrolli, nëse ka, procedurat e sigurisë, procedurat e arkivimit, ndarjen e detyrave dhe raportimin e dobësive të kontrollit të brendshëm.

Aktivitete monitoruese (mbikëqyrja e ndërhyrjeve) përfshirë auditin e brendshëm dhe mbajtjen e raporteve dhe rekomandimeve të auditeve, vlerësimet.

Komunikimi (të bëhet e mundur që të gjithë aktorët të marrin informacionin e nevojshëm për kryerjen e rolit të tyre) përfshirë bashkërendimin e rregullt të takimeve midis organeve të ndryshme me qëllim shkëmbimin e informacionit mbi të gjitha aspektet e planifikimit dhe zbatimit, si dhe raportimit të rregullt në të gjitha nivelet përkatëse, për sa i takon efikasitetit të kontrollit të brendshëm.

2. Koordinatori kombëtar IPA (KKIPA):

a) KKIPA caktohet nga Përfituesi. Ai duhet të jetë zyrtar i lartë i qeverisë ose administratës shtetërore të Përfituesit.

KKIPA siguron bashkërendimin e përgjithshëm të asistencës në kuadrin e IPA-s.

KKIPA siguron partneritet ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit dhe lidhje të ngushtë midis procesit të përgjithshëm të aderimit dhe asistencës parazgjerim në kuadrin e asistencës IPA. Ai mban përgjegjësinë e përgjithshme për:

- koherencën dhe bashkërendimin e programeve të siguruara nën kuadrin e IPA-s;

- programimin vjetor për komponentin e asistencës transitore dhe forcimit institucional në nivel kombëtar;

- bashkërendimin e pjesëmarrjes së Përfituesit në programe ndërkufitare si me Shtetet Anëtare, ashtu edhe me shtete të tjera Përfituese, si dhe programet transkombëtare, ndërrajonale dhe të gjireve detare në kuadrin e instrumenteve të tjera komunitare. NIPAC mund t'i delegojë te një koordinator detyrat që lidhen me këtë bashkëpunim ndërkufitar.

KKIPA, pas shqyrtimit nga komiteti monitorues IPA, harton dhe paraqet te Komisioni raportet vjetore dhe përfundimtare IPA mbi zbatimin siç përcaktohet në nenin 40 të Marrëveshjes kuadër dhe në nenin 61(3) të rregullores zbatuese IPA. KKIPA i dërgon ZKA-së një kopje të këtyre raporteve.

3. Koordinatori strategjik:

a) Një koordinator strategjik caktohet nga Përfituesi për të siguruar bashkërendimin e komponentit të zhvillimit rajonal dhe komponentit të zhvillimit të burimeve njerëzore. Koordinatori strategjik cilësohet si ent brenda administratës shtetërore të Përfituesit, i vendosur nën përgjegjësinë e KKIPA-ut dhe pa përfshirje të drejtpërdrejtë në zbatimin e komponentëve përkatës;

b) Koordinator strategjik në veçanti:

- bashkërendon asistencën e dhënë nën komponentin e zhvillimit rajonal dhe komponentit të zhvillimit të burimeve njerëzore;

- harton kuadrin strategjik të koherencës siç përcaktohet në nenin 154 të rregullores zbatuese IPA;

- siguron bashkërendim ndërmjet strategjive sektoriale dhe programeve.

4. Zyrtari kombëtar i autorizuar (ZKA):

ZKA caktohet nga Përfituesi. Ai duhet të jetë një zyrtar i lartë i qeverisë ose i administratës shtetërore të Përfituesit.

ZKA kryen funksionet e mëposhtme dhe ndërmerr përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Si kryetar i fondit kombëtar, është përgjegjës i përgjithshëm për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në (vendi) dhe është përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve. NAO veçanërisht kryen detyrat e mëposhtme, për sa u përket këtyre përgjegjësive:

- garanton rregullsinë dhe ligjshmërinë e transaksioneve;
- harton dhe i paraqet Komisionit deklarata të noterizuara të shpenzimeve dhe mandat pagesave; mban përgjegjësi të përgjithshme për saktësinë e mandatit të pagesës dhe për transferimin e fondeve te strukturat operuese dhe/ose Përfituesit përfundimtar;
- verifikon ekzistencën dhe saktësinë e elementeve bashkëfinancuese;
- bën evidentimin dhe komunikimin e menjëhershëm të çfarëdo parregullsie;

- bën rregullimet financiare që kërkohen në lidhje me parregullsitë e konstatuara, në përputhje me nenin 50 të rregullores zbatuese IPA;
- është pika e kontaktit për informacion financiar ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit.

b) Është përgjegjës për funksionimin efikas të sistemit menaxhues dhe kontrollues në kuadrin e IPA-s. ZKA kryen veçanërisht detyrat e mëposhtme, për sa i përket këtyre përgjegjësive:

- është përgjegjës për dhënien, monitorimin dhe pezullimin apo tërheqjen e akreditimit të strukturave operuese;
- siguron ekzistencën dhe funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit të asistencës në kuadrin e IPA-s;
- garanton që sistemi i kontrollit të brendshëm në lidhje me menaxhimin e fondeve të jetë efikas;
- raporton për sistemin menaxhues dhe kontrollues;
- garanton që të funksionojë një sistem i saktë raportimi dhe informimi;
- ndjek konstatimet e raporteve të auditeve të kryera nga autoriteti i auditimit, në përputhje me nenin 18 të Marrëveshjes kuadër dhe nenin 30(1) të rregullores zbatuese IPA;
- menjëherë njofton Komisionin, me një kopje të njoftimit që i dërgon ZPA, për ndonjë ndryshim thelbësor në lidhje me sistemet menaxhuese dhe kontrolluese.

Bazuar në përgjegjësitë nën pikat a) dhe b) më lart, ZKA harton një deklaratë vjetore sigurie siç përcaktohet në nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe sipas aneksit B të kësaj Marrëveshjeje, që përfshin:

a) konfirmim të funksionimit efikas të sistemeve menaxhuese dhe kontrolluese;

b) konfirmim në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve;

c) informacion për ndonjë ndryshim në sistemet e kontrollit dhe elementet e informacionit mbështetës për kontabilitetin.

Nëse konfirmimi në lidhje me funksionimin efikas të sistemeve menaxheriale dhe kontrolluese, si dhe me ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve a) dhe b) lart nuk janë të disponueshme, ZKA duhet të informojë Komisionin, duke ia përcjellë edhe ZPA, arsyet dhe pasojat e mundshme, si dhe për masat që ndërmerren për ta zgjidhur këtë situatë dhe për të mbrojtur interesat e Komunitetit.

5. Fondi kombëtar (FK):

a) FK është një organ në nivelin ministror në shtetin e Përfituesit dhe ka kompetenca qendrore buxhetore dhe vepron si ent qendror i thesarit.

b) FK ka për detyrë të merret me detyrat e menaxhimit financiar të asistencës në kuadrin e IPA-s, nën përgjegjësinë e ZKA-së.

c) FK veçanërisht është përgjegjës për organizimin e llogarive bankare, kërkesat për fonde nga Komisioni, autorizimin e transferimit të fondeve nga Komisioni te strukturat operuese ose te Përfituesit përfundimtarë dhe për raportimin financiar para Komisionit.

6. Strukturat operuese:

a) Për secilin komponent apo program IPA ngrihet një strukturë operative që merret me menaxhimin dhe zbatimin e asistencës IPA. Struktura operuese është një organ institucional ose një grup organesh institucionale brenda administratës së Përfituesit.

b) Struktura operuese është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programeve IPA në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar. Për këtë qëllim, struktura operuese ka disa funksione ku përfshihen:

- harton programe vjetore ose shumëvjeçare;

- programon monitorimin dhe drejton punën e komitetit monitorues sektorial siç përcaktohet nga neni 36(2) i Marrëveshjes kuadër dhe në nenin 59 të rregullores zbatuese IPA, veçanërisht duke siguruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e zbatimit të programeve;

- harton raportet vjetore sektoriale dhe përfundimtare zbatimi siç përcaktohet në nenin 38(1) dhe (2) të kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe në nenin 61(1) të rregullores zbatuese IPA dhe, pas shqyrtimit të tyre nga ana e komitetit monitorues sektorial, ia paraqet ato Komisionit, KKIPA dhe ZKA;

- garanton që operacionet të zgjidhen për financim dhe të miratohen në përputhje me kriteret dhe mekanizmat e zbatueshme për këto programe dhe që ato të jenë në pajtim me rregullat përkatëse komunitare dhe kombëtare;

- krijon procedura për të garantuar mbajtjen e të gjitha dokumenteve për shpenzimet dhe auditet që kërkohen për një audit të përshtatshëm;

- organizon procedurat tenderuese, jep procedurat e projekteve, bën pagesa dhe bën rikuperimet nga Përfituesi përfundimtar;

- garanton që të gjitha organet e përfshira në zbatimin e operacioneve të mbajnë një sistem të vet kontabiliteti ose një kodifikim kontabiliteti të tyrin;

- garanton që FK dhe ZKA të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurat dhe verifikimet e arritura në lidhje me shpenzimet;

- ngre, mirëmban dhe përditëson sistemin e përditësimit dhe informimit;

- bën verifikimet për të garantuar që shpenzimet e deklaruara të jenë bërë në përputhje me rregullat e zbatueshme, që produktet dhe shërbimet të shpërndahen në përputhje me vendimin e miratuar; dhe pagesat e kërkuara nga Përfituesi përfundimtar të jenë korrekte. Këto verifikime mbulojnë aspekte administrative, financiare, teknike dhe fizike, si të jetë e përshtatshme;

- garanton auditin e brendshëm të organeve të ndryshme përbërëse të tij;

- garanton raportim të parregullsive;

- garanton pajtueshmëri me informacionin dhe kërkesat për publicitet.

c) Kryetarët e organeve përbërëse të strukturës operuese emërohen në mënyrë të qartë dhe janë përgjegjës për detyrat që u ngarkohen organeve të tyre përkatëse, në përputhje me nenin 8(3) të kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe me nenin 11(3) të rregullores zbatuese IPA.

7. Autoriteti i auditimit:

a) Autoriteti i auditimit emërohet nga Përfituesi dhe është i pavarur nga ana funksionale nga të gjithë aktorët në sistemin menaxhues dhe kontrollues dhe që janë në përputhje me standardet e auditit të pranuara ndërkombëtarisht;

b) Autoriteti i auditimit është përgjegjës për verifikimin e funksionimit efikas dhe të shëndoshë të sistemeve menaxhuese dhe kontrolluese;

c) Autoriteti i auditimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, kryen veçanërisht funksionet e mëposhtme dhe merr përsipër përgjegjësit e mëposhtme:

- kryerjen e një plani pune auditi vjetor, që përfshin audite që synojnë të verifikojnë:

- funksionimin efikas të sistemeve menaxhuese dhe kontrolluese;

- besueshmërinë e informacionit kontabël që i përcillet Komisionit.

Puna e auditit përfshin auditet nga një sërë operacionesh dhe transaksionesh që merren si model, dhe shqyrtimin e procedurave.

Plani i punës për auditin vjetor i dorëzohet ZKA dhe Komisionit para fillimit të vitit në fjalë.

Dorëzimin e raporteve dhe opinioneve, si më poshtë:

Një raport vjetor i aktiviteteve audituese sipas modelit në aneksin C të kësaj Marrëveshjeje Kuadër dhe rendit burimet e përdorura nga autoriteti auditues, si dhe bën një përmbledhje të pikave të dobëta të konstatuara në sistemin menaxhues dhe kontrollues ose në transaksione, të cilat janë evidentuar nga transaksionet e kryera në përputhje me planin e punës për auditin vjetor të përgatitur gjatë 12 muajve të mëparshëm, që përfundon më 30 shtator të viti në fjalë. Raporti i aktivitetit vjetor audituesi i dorëzohet Komisionit, ZKA dhe ZPA deri më 31 dhjetor të secilit vit. I pari raport i tillë mbulon periudhën 1 janar 2007-30 nëntor 2007.

Një opinion vjetor auditi sipas modelit të paraqitur në aneksin D të kësaj Marrëveshjeje Kuadër, që tregon nëse sistemet menaxhuese dhe kontrolluese funksionojnë me efikasitet dhe në pajtim me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe rregullores zbatuese IPA dhe/ose ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit. Ky opinion i adresohet Komisionit, ZKA dhe ZPA. Opinioni mbulon të njëjtën periudhë dhe kanë të njëjtin afat si raporti vjetor i aktiviteteve audituese.

Një opinion apo deklaratë finale të shpenzimeve që i dorëzohet Komisionit nga ZKA, për mbylljen e çfarëdo programi ose të ndonjë pjesë të tij. Kur është e përshtatshme, deklarata finale e shpenzimeve mund të përfshijë mandatet e pagesave në formën e kontabilitetit, të hedhura çdo vit. Ky opinion adreson vlefshmërinë e aplikimit për pagesën e fundit (përfundimtare) dhe, kur është e nevojshme mbështetet nga raporti final i aktiviteteve audituese. Ai bëhet sipas modelit të dhënë në aneksin E të kësaj Marrëveshjeje kuadër dhe i dërgohet Komisionit dhe ZPA në të njëjtën kohë me deklaratën finale përkatëse të shpenzimeve që i dorëzohet ZKA, ose të paktën brenda tre muajve pas dorëzimit të deklaratës finale të shpenzimeve.

Kërkesa të tjera specifike për planin vjetor të punës për auditin dhe/ose raportet dhe opinionet e përmendura më lart mund të paraqiten në marrëveshjet sektoriale dhe marrëveshjet financiare.

Për sa i përket metodologjisë së punës audituese, raporteve dhe opinioneve audituese, autoriteti i auditimit duhet të ndjekë standardet ndërkombëtare për auditimin dhe veçanërisht, për sa i përket fushave të menaxhimit të riskut, materies për auditim dhe kampionimit. Metodologjia mund të plotësohet me udhëzime të mëtejshme dhe përkufizime nga Komisioni, sidomos në lidhje me përqasjen e përgjithshme të kampionimit, niveleve të konfidencës dhe materies.

ANEKSI B
I MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT DHE QEVERISË SË (SHTETI)
DEKLARATË GARANCIE[8]
E ZYRTARIT KOMBËTAR TË AUTORIZUAR TË (VENDI)[9]

Unë, (mbiemri, emri, titulli zyrtar ose funksioni), zyrtar kombëtar i autorizuar i (vendi) i paraqes Komisionit deklaratën e shpenzimeve, relacionet financiare dhe deklaratën e shpenzimeve të instrumentit të parazgjerimit (IPA) për (vendi), për vitin financiar 01/01/20xx deri më 31/12/20xx.

Deklaroj se kam organizuar dhe mbikëqyrur operacionin e menaxhimit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në lidhje me komponentin IPA 1 deri në 5 (Deklarata e menaxhimit vjetor).

Konfirmoj, bazuar në gjykimin tim dhe informacionet që disponoj, përfshirë midis të tjerave rezultatet e punës së auditimit të brendshëm, se:

Shpenzimet e deklaruara [dhe relacionet financiare të dorëzuara]3 Komisionit gjatë vitit financiar 01/01/20 deri më 31/12/20xx japin3 [jep], sipas njohurive të mia maksimale, situacionin e vërtetë, të plotë dhe të saktë të shpenzimeve dhe faturave lidhur me komponentin IPA 1 deri në 5 për vitin financiar të lartpërmendur;

Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit ka funksionuar me efikasitet dhe ka siguruar garancitë e arsyeshme për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve, përfshirë midis të tjerave pasqyrim të parimeve të menaxhimit të shëndoshë financuar;

Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit që funksionon për komponentin 1 deri në 5 nuk është ndryshuar [ndjeshëm] 4 krahasuar me përshkrimin e përcaktuar në momentin e dorëzimit të aplikimit për dhënien e kompetencës menaxhuese (duke pasur parasysh ndryshimet që i janë njoftuar Komisionit vitet e mëparshme);

Të gjitha marrëveshjet kontraktuale që kanë lidhje apo efekt material mbi shpenzimet e deklaruara [dhe relacionet financiare të dorëzuara] 3 gjatë periudhës referuese, që nuk ishin në pajtim, tashmë janë të përputhshme. Nuk ka pasur incidente mospajtimi me rregullat e Komunitetit që mund të rezultonin në efekte materiale mbi shpenzimet e deklaruara [dhe llogaritë e dorëzuara] 3 në rast mospajtimi.

Konfirmoj se, ku ka qenë e nevojshme, kam marrë masat e përshtatshme bazuar në raportet dhe opinionet e autoritetit të auditimit të hartuara deri tani, sipas nenit 29 të rregullave zbatuese të IPA-s.

[Megjithatë, këto garanci janë objekt i konsiderimeve të mëposhtme <të përshkruhen edhe masat korrigjuese>:

…

…].

Konfirmoj se nuk jam në dijeni të ndonjë informacioni të fshehtë, që mund të dëmtojë interesat

[8] Për komponent.

[9] Sipas nenit 27 të rregullave zbatuese të IPA-s.

[3] Opsionet për komponentin 5 mbeten për t'u zgjedhur.

[4] Aty ku është e përshtatshme.

financiare të Komunitetit.

(Vendi dhe data e nënshkrimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i zyrtarit kombëtar të autorizuar)

ANEKSI C

I MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT DHE QEVERISË SË (VENDI)

RAPORT VJETOR I AKTIVITETEVE AUDITUESE[10]

I AUTORITETIT TË AUDITIMIT TË (SHTETI)[11]

Drejtuar:

- Komisionit Europian, Drejtoria e Përgjithshme…
- Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA) të (vendi) dhe
- [për dijeni][12] Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar (ZKA) të (vendi)

1. Hyrje

- Identifikoni komponentin/programin IPA që mbulon ky raport.

Tregoni organet që morën pjesë në përgatitjen e raportit, përfshirë edhe autoritetin e auditimit.

Përshkruani hapat e marra për përgatitjen e raportit.

Tregoni shtrirjen e auditeve (përfshirë shpenzimet e deklaruara Komisionit për vitin në fjalë, në lidhje me operacionet përkatëse).

Tregoni periudhën që mbulon ky raport vjetor i aktiviteteve audituese (12 muajt e mëparshëm që përfundojnë më 30.9.20xx).

2. Përmbledhje e konstatimeve

Përshkruani natyrën dhe shkallën e konstatimeve nga të dy sistemet dhe testimi i pavarur. (Kategorizoni këto konstatime sipas rëndësisë "të mëdha, "mesatare" dhe "të vogla". Lista e këtyre konstatimeve tregohet në aneksin e këtij raporti). Tregoni gabimet që konsiderohen të natyrës sistematike dhe vlerësoni mundësinë e një kualifikimi të mundshëm, si rrjedhojë e këtyre gabimeve. Përshkruani dhe jepni sasinë e parregullsive të gjetura.

3. Ndryshimet në sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit

Tregoni ndryshimet e ndjeshme në sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit, krahasuar me përshkrimin e dhënë në momentin e dorëzimit të aplikimit për dhënien e kompetencës menaxhuese (menaxhim i centralizuar) dhe që nga raporti i fundit vjetor për aktivitetet audituese.

Konfirmoni, nëse ndryshimet e konstatuara janë komunikuar nga ZKA sipas aneksit A 4) b) të Marrëveshjes kuadër.

4. Ndryshimet në planit vjetor të punës për auditin

Tregoni ndryshimet që janë propozuar ose i janë bërë planit vjetor të punës për auditin, duke dhënë shpjegime dhe arsye.

Përshkruani përqasjen e auditit të ndjekur në përgjigje të ndryshimeve të renditura më lart.

Përshkruani implikimet e ndryshimeve dhe devijimet, përfshirë kriteret për kryerjen e ndonjë auditi shtesë në kontekstin e ndryshimeve në planin vjetor të punës për auditin.

5. Auditet e sistemeve

Tregoni organet që kanë kryer testime të sistemeve për qëllimet e këtij raporti, përfshirë edhe vetë autoritetin e auditimit.

Bashkëngjisni listën përmbledhëse, të auditeve të kryera; tregoni për cilat çështje është bërë, si dhe nivelin e besueshmërisë (%), kur është e nevojshme, si dhe datën kur raporti i auditimit i është përcjellë Komisionit.

Përshkruani kriterin e zgjedhjes së auditeve në kontekstin e planit vjetor të punës për auditin.

Përshkruani konstatimet kryesore dhe përfundimet e nxjerra nga puna audituese për sistemet e

[10] Për komponent.

[11] Sipas nenit 29(2)(b) të rregullores zbatuese IPA.

[12] Opsionet për komponentin 5 mbeten për t'u përcaktuar.

menaxhimit dhe të kontrollit, përfshirë përshtatshmërinë e kronologjisë së auditimit dhe pajtimin me kërkesat dhe politikat e Komunitetit.

Jepni informacion për ndjekjen e konstatimeve të auditit dhe në veçanti për masat korrigjuese apo parandaluese të zbatuara apo të rekomanduara.

6. Auditet e kampionimit të operacioneve

Tregoni organet që kanë kryer testime të pavarura për qëllimet e këtij raporti, përshirë edhe vetë autoritetin e auditimit.

Bashkëngjisni një listë përmbledhëse, ku të tregohet numri i auditeve të kryera, për cilat çështje janë bërë, si dhe nivelin e besueshmërisë (%), kur është e nevojshme, si dhe shumën e shpenzimeve të kontrolluara, të ndarë në komponentë, akse prioritetesh të programit dhe/ose masash, kur është me vend, duke bërë, kur është e nevojshme ndarjen midis kampionimit statistikor nga ai bazuar në risk. Jepni përqindjen e shpenzimeve të kontrolluara në lidhje me shpenzimet totale që i janë deklaruar Komisionit (të dyja për periudhën në fjalë dhe në mënyrë kumulative).

Përshkruani kriterin për përzgjedhjen e operacioneve që inspektohen.

Përshkruani rezultatet kryesore të testimit të pavarur, duke dhënë sidomos shkallën e përgjithshme të gabimeve financiare në përpjesëtim me shpenzimet totale të audituara, që rezultojnë nga kampionimi.

Jepni informacione mbi ndjekjen e gabimeve, zbatimin e ndonjë mase financiare korrigjuese dhe/ose plani veprimi korrigjues.

Tregoni korrigjimet financiare të bëra.

7. Bashkërendimi ndërmjet organeve audituese dhe puna mbikëqyrëse e autoritetit të auditimit

Përshkruani procedurën për bashkërendimin ndërmjet organeve kombëtare dhe vetë autoritetit të auditimit, (nëse është e zbatueshme).

Përshkruani procedurën për mbikëqyrjen që bën autoriteti i auditimit ndaj organeve të tjera audituese, (nëse është e zbatueshme).

8. Ndjekja e aktiviteteve audituese të viteve të kaluara

Jepni informacione, kur është e nevojshme, për ndjekjen e rekomandimeve të auditeve dhe rezultatet e auditeve nga vitet e kaluara.

9. Burimet e përdorura nga autoriteti i auditimit

Përshkruani burimet e përdorura për përgatitjen e këtij raporti vjetor për aktivitetet audituese.

Aneks: Plani i punës i auditit vjetor për vitin e referuar (12 muajt e mëparshëm duke mbaruar më 30.09.20xx)

[Lista e konstatimeve, sipas pikës 2 më lart]

[Lista e ndryshimeve, sipas pikës 4 më lart]

[Listë përmbledhëse, sipas pikës 5 më lart, duke ndjekur modelin bashkëshoqërues]

[Listë përmbledhëse, sipas pikës 6 më lart, duke ndjekur modelin bashkëshoqërues]

[Listë përmbledhëse, sipas pikës 5 më lart, për sistemet e auditeve]

Data e kryerjes së auditit të sistemeve	Programi/sistemi i audituar	Subjekti audites	Shpenzimet e deklaruara në vitin e referuar	Shpenzimet totale kumulative të deklaruara	Kriteri për përzgjedhjen e programit

[Listë përmbledhëse, sipas pikës 6 më lart] PËR SHPENZIMET E DEKLUARA DHE AUDITET KAMPION

Fondi	Referenca (nr. CCI)	Programi	Shpenzimet e deklaruara në vitin e referuar	Shpenzimet e vitit të referuar, të audituara për kampionimin e rastësishëm		Shuma dhe përqindja (shkalla e gabimit) e shpenzimeve të parregullta në kampionimin e rastësishëm (3)		Shpenzime të tjera të audituara (4)	Shuma e shpenzimeve të parregullta në kampionim dhe të tjera shpenzime	Shpenzimet totale të deklaruara në mënyrë kumulative	Shpenzimet totale të audituara në mënyrë kumulative si përqindje e shpenzimeve totale të deklaruara në mënyrë kumulative	Shkalla e çështjeve të mbuluara (%)	Niveli i besueshmërisë (%)
				1.	2.	Shuma	%	1.					

1. Shuma e shpenzimeve e audituar.

2. Përqindja e shpenzimeve e audituar në lidhje me shpenzimet që i janë deklaruar Komunitetit për vitin e referuar.

3. Kur kampioni i rastësishëm mbulon më tepër se një fond apo program, informacioni jepet për të gjithë kampionin.

4. Shpenzime nga kampionim shtesë dhe shpenzime për kampionim të rastësishëm që nuk janë përcaktuar në vitin e referuar.

ANEKSI D
I MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT DHE QEVERISË SË (VENDI) [1]
OPINION VJETOR AUDITIMI
I AUTORITETIT I AUDITIMIT TË (VENDIT) PËR MENAXHIMIN DHE SISTEMET E KONTROLLIT

Drejtuar:
- Komisionit Europian, Drejtoria e Përgjithshme…
- Zyrtarit përgjegjës akreditues (ZPA) të (vendi) dhe
- [për dijeni][2] Zyrtarit kombëtar të autorizuar (ZKA) të (vendi)

Hyrje:

Unë, (mbiemri, emri, titulli zyrtar ose funksioni), kryetar i autoritetit të auditimit të (vendit), (emri i autoritetit të auditimit përgjegjës), kam ekzaminuar funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit për operacionet nën komponentin [1 deri në 5] të instrumentit të parazgjerimit (IPA) për periudhën gjatë 12 muajve të mëparshëm që përfundoi më (data), siç është paraqitur në përshkrimin e dërguar Komisionit më (data) në momentin e dorëzimit të aplikimit, për dhënien e kompetencës menaxhuese, (duke pasur parasysh ndryshimet që i janë njoftuar Komisionit vitet e mëparshme më (datë) bashkë me ndryshimet e identifikuara në raportin vjetor të aktiviteteve audituese që shoqëron këtë opinion.

Objektivi i këtij shqyrtimi është dhënia e një opinioni për pajtueshmërinë e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit me Marrëveshjen Kuadër dhe/ose me ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (vendi) në kuadrin e IPA-s, si dhe nëse këto sisteme të menaxhimit dhe kontrollit, të ideuar për të kontribuar në përpilimin e [deklaratave të shpenzimeve] [llogarive financiare dhe deklaratave të shpenzimeve][3] të besueshme që i paraqiten Komisionit, dhe rrjedhimisht të garantojë, midis të tjerave, ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në këto deklarata, kanë operuar me efikasitet.

Përgjegjësitë përkatëse të ZKA dhe audituesve:

ZKA është përgjegjës, midis të tjerash, për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të deklaratës së garantimit sipas nenit 25 të rregullores zbatuese IPA (IPA IR). Kjo përgjegjësi përfshin përgatitjen e një prezantimi që është i vërtetë, i plotë dhe i saktë për shpenzimet e deklaruara [dhe llogaritë financiare të dorëzuara] 3 Komisionit, si dhe për të përcaktuar nëse funksionimi efikas i sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit në kuadrin e IPA-s jep garanci për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të deklaratës.

ZKA duhet të bazojë vlerësimet e tij/saj mbi informacionin që ka në dispozicion. Kjo përfshin punën e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Përgjegjësia ime në këtë raport, në përputhje me nenin 29(2)(b) pika e dytë e IPA IR – është shprehja e një opinioni mbi funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të vendosur për operacionet në kuadrin e komponentit [1 deri në 5] IPA gjatë periudhës 12-mujore të mëparshme që përfundoi më (data) në të gjitha aspektet materiale.

Auditet tona organizohen duke pasur këtë në mendje (bashkë me objektivin për të siguruar opinione mbi shpenzimet e deklaruara [dhe llogaritë financiare vjetore të Komponentit 5][4] dhe deklaratat përfundimtare për pagim). Ne organizojmë një plan pune të përgjithshëm për auditimin në mënyrë që të përmbushim të gjitha përgjegjësitë tona sipas nenit 29 të IPA IR. Ne planifikuam dhe kryem auditimet jo me këndvështrimin që të japim një opinion të përgjithshëm për besueshmërinë e deklaratës së garantimit të ZKA. Megjithatë, japim përfundimet tona, nëse rezultatet e punës audituese të kryer prej nesh, na ngjallin ndonjë dyshim në lidhje me deklaratën e garantimit. Në veçanti, ne kemi vlerësuar, nëse konstatimet e

[1] Për komponent.
[2] Opsionet për komponentin 5 mbeten për t'u përcaktuar.
[3] Opsion për t'u përcaktuar në varësi të komponentit.
[4] Opsioni për komponentin 5 mbetet për t'u përcaktuar.

auditimit janë në përputhje me praninë apo mungesën e rezervave në deklaratën e garantimit të ZKA. Ne i kryem auditimet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Këto standarde kërkojnë, mes të tjerash, që të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditet për të marrë garanci të arsyeshme mbi të cilat të bazojmë opinionin tonë.

Besoj se puna e kryer jep një bazë të shëndoshë për opinionin tonë.

Shtrirja e shqyrtimit:

Detyrat e auditimit u kryen në përputhje me planin vjetor të punës për aktivitetet audituese sipas këtij komponenti gjatë periudhës 12-mujore në fjalë dhe që raportohet në raportin vjetor të aktiviteteve audituese që mbulon periudhën deri më… (data).

Auditi ynë bazuar në sisteme përfshinte shqyrtim, me bazë testuese, të disenjimit dhe operimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, të ngritur nga Përfituesi për të menaxhuar me efikasitet risqet që kërcënojnë përgatitjen e [deklaratave të shpenzimeve] [llogarive financiare dhe deklaratave të shpenzimeve]3 të besueshme që i paraqiten Komisionit.

Tregoni ndonjë kufizim të shtrirjes së shqyrtimit:

Shpjegoni kufizimet

Opinioni i audituesit:

Opsioni 1 – Opinion i pakualifikuar

Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur, opinioni im është që për periudhën nga 1 tetori 20xx deri më 30 shtator 20xx+1) sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritur për komponentin [1 deri në 5] kontribuojnë në përgatitjen e [deklaratave të shpenzimeve] [llogarive financiare dhe deklaratave të shpenzimeve]3 të besueshme që i paraqiten Komisionit, dhe funksionuan me sukses për të garantuar midis të tjerash ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të këtyre deklaratave. Në lidhje me disenjimin dhe operimin, ato ishin në përputhje me aspektet materiale të të gjitha kërkesave të zbatueshme të Marrëveshjes kuadër IPA dhe/ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA-s. Pa shprehur opinion për besueshmërinë e përgjithshme të deklaratës së garancisë, dola në përfundimin se kjo deklaratë e garancisë e lëshuar nga ZKA, nuk përmbante të dhëna që të jenë materialisht të papërputhshme me konstatimet e auditimit tonë dhe rrjedhimisht nuk krijojnë dyshime për përgatitjen me saktësi të Deklaratës së garancisë dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Auditimet u kryen nga data DD/MM/20YY deri më DD/MM/20YY. Një raport i konstatimeve të mia është dorëzuar në të njëjtën datë me atë të këtij opinioni.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit të auditimit përgjegjës)

Opsioni 2 – Opinioni i kualifikuar[1]

Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur, opinioni im është që për periudhën nga 1 tetori 20xx deri më 30 shtator 20xx+1) sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të vendosura për komponentin [1 deri në 5] për të kontribuar në përgatitjen e [deklaratave të shpenzimeve [llogarive financiare dhe deklaratave të shpenzimeve]3 të besueshme që i paraqiten Komisionit dhe që ndihmojnë, përveç të tjerash në garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve në këto deklarata, funksionuan me efikasitet. Ndërsa për disenjimin dhe operimin, ato ishin në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kërkesat e zbatueshme të Marrëveshjes kuadër IPA dhe/ose me çdo marrëveshje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA, përveç aspekteve të mëposhtme:

Përcaktoni dhe shpjegoni të metat (qoftë për shkak të mosmarrëveshjeve me ZKA apo për kufizimet e shtrirjes); veçanërisht tregoni organet përgjegjëse.

Tregoni nëse mangësitë janë të përsëritura apo ndodhin vetëm një herë.

Për pasojë, [(vendi)] [autoriteti…] [aktor(ë) tjetër/të tjerë)] nuk ka arritur të respektojë kërkesat e Marrëveshjes Kuadër IPA dhe/ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA-s.

Sipas vlerësimit tim, impakti i të metave është... eur [%] i shpenzimeve totale të deklaruara, që korrespondon me.... eur [%] të kontributit publik. Kontributi i Komunitetit që është dëmtuar është... Pa shprehur opinion për besueshmërinë e përgjithshme të deklaratës së garantimit në tërësi, dola në

[1] E zbatueshme ose për shkak mosmarrëveshjesh me ZKA-në, ose për shkak kufizimi të fushës së veprimit.

përfundimin që deklarata e garantimit e lëshuar nga ZKA përmbante të dhëna që janë materialisht të papërputhshme me konstatimet e auditimit tonë dhe që rrjedhimisht krijojnë dyshime se deklarata e garancisë nuk është përgatitur saktë dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm përkatës. Këto rezerva dhe mungesa pajtueshmërie janë: <përshkruani rezervat>

Auditimet u kryen nga data DD/MM/20YY deri më DD/MM/20YY. Një raport i konstatimeve të mia është dorëzuar në të njëjtën datë me atë të këtij opinioni.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i Kryetarit të Autoritetit të Auditimit përgjegjës)

Opsioni 3 – Opinion i kundërt

Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur, opinioni im është që për periudhën nga 1 tetori 20xx deri më 30 shtator 20xx+1) sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të vendosura për komponentin [1 deri në 5] për të kontribuar në përgatitjen e [deklaratave të shpenzimeve [llogarive financiare dhe deklaratave të shpenzimeve]3 të besueshme, që i paraqiten Komisionit dhe që ndihmojnë, përveç të tjerash në garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve në këto deklarata, nuk funksionuan me efikasitet. Në lidhje me disenjimin dhe operimin, nuk arritën të jenë në përputhje, në shumë aspekte të rëndësishme, me kërkesat e zbatueshme të Marrëveshjes kuadër IPA dhe/ose me ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA-s.

Ky opinion i kundërt bazohet në vëzhgimet/vëzhgimin e mëposhtme/e mëposhtëm:

Përshkruani rrethanat që i japin shkas rezervave bashkë me implikimet e rëndësishme të mospërputhjes me rregullat e Komunitetit dhe jepni emrat e organeve të cenuara, nëse ka.

Për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin pararendës,[(vendi)] [autoriteti…] [aktor(ë) tjetër/të tjerë] nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e Marrëveshjes kuadër IPA dhe/ose me ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA-s.

Auditimet u kryen nga data DD/MM/20YY deri më DD/MM/20YY. Një raport i konstatimeve të mia është dorëzuar në të njëjtën datë me atë të këtij opinioni.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit të auditimit përgjegjës)

Opsioni 4 – Mungesë opinioni

Për shkak të rëndësisë së çështjes së diskutuar në paragrafin pararendës, unë nuk shpreh opinion mbi efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit nën komponentin IPA [1 deri në 5] për periudhën nga 1 tetori 20xx deri më 30 shtator 20xx+1, si dhe mbi pajtueshmërinë e tyre me Marrëveshjen kuadër IPA dhe/ose me ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Komisionit dhe (shtetit) në kuadrin e IPA-s. Pa shprehur mendim për besueshmërinë e përgjithshme të deklaratës së garancisë në tërësi, dola në përfundimin se deklarata e garancisë e lëshuar nga ZKA përmbante të dhëna që janë materialisht të papërputhshme me konstatimet e auditimit tonë dhe rrjedhimisht krijojnë dyshime nëse deklarata e garancisë është përgatitur me saktësi dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm përkatës. Këto rezerva dhe mungesa pajtueshmërie janë: <përshkruani rezervat>

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit të auditimit përgjegjës)

[për dijeni: Nëpunësit kombëtar të autorizuar (NKA) të (vendit)]

SHTOJCA E

E MARRËVESHJES KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT DHE QEVERISË SË (SHTETIT)1

OPINION AUDITIMI

[1] Për komponent.

I Autoritetit Auditues të (vendit)[1]
{për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve për {programin me referencë: …}
{për llogaritë financiare dhe deklaratën e shpenzimeve të komponentit 5}[2]
{për një pjesë … të programit me referencë:…}
{e mbështetur nga raporti përfundimtar i aktiviteteve audituese}[3]

Adresuar:
- Komisionit Europian, Drejtorisë së Përgjithshme të…,
- Nëpunësit të akredituar kompetent (NAK) të (vendi)

1. Hyrje

Unë, (mbiemri, emri, titulli zyrtar dhe funksioni), kryetar i autoritetit auditues të (vendi), (emri i autoritetit auditues përgjegjës), kam shqyrtuar rezultatet e punës audituese të kryera për programin (tregoni programin – titulli, komponenti, periudha, numri (CCI) i referencës) me ose nën përgjegjësinë e Autoritetit Auditues, në përputhje me planin e punës për auditimin [dhe kam kryer punë shtesë të nevojshme sipas gjykimit tim].

2. Përgjegjësitë përkatëse të nëpunësit kombëtar të autorizues dhe audituesve

Në përputhje me nenin 25 të rregullores zbatuese IPA (IPA IR) NKA është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të deklaratave të shpenzimeve që i paraqiten Komisionit, si dhe për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në këto deklarata.

{Kjo përgjegjësi përfshin: disenjimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm optimal për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të llogarive financiare vjetore që nuk përmbajnë deklarime të gabuara materiale, qoftë për gabim njerëzor apo mashtrim, si dhe për përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabiliste; si dhe për të bërë përllogaritje financiare të arsyeshme për rrethanat}[3].

Përgjegjësia ime në këtë raport – sipas nenit 29 (2) (b) pika 3 e IPA IR3 – është shprehja e një opinioni {për besueshmërinë e deklaratës përfundimtare të shpenzimeve}[3] {dhe vlefshmërinë e aplikimit për pagesën përfundimtare} e dorëzuar nga NKA. Auditimet e kryera nga unë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Këto standarde kërkojnë që unë të planifikojë dhe të kryejë auditimet me qëllim që të marr garanci të arsyeshme për të vlerësuar nëse deklarata e shpenzimeve {dhe llogaritë financiare}[3] {dhe aplikimin për pagesën për bilancin përfundimtar të kontributit që jep Komuniteti në program}, nuk përmbajnë të dhëna të gabuara {si dhe efikasitetin e procedurave të kontrollit të brendshëm}[3].

Ne organizojmë një plan pune të punës për auditimin në mënyrë që të përmbushim përgjegjësitë që na ngarkon neni 29 i IPA IR. Auditimet përfshijnë {ekzaminimin me bazë testuese e të dhënave mbështetëse të shumave dhe të dhënave në deklaratën përfundimtare të shpenzimeve si dhe në aplikimin për pagesë për bilancin përfundimtar të kontributit që jep Komuniteti në program} (shqyrtimin me bazë testuese të të dhënave mbështetëse të informacionit që përmbajnë llogaritë financiare vjetore, ekzaminim të procedurave dhe të kampionimit të duhur të transaksioneve, për të marrë të dhëna auditimit rreth shumave dhe të dhënave në deklaratën e shpenzimeve dhe në llogaritë financiare vjetore}[3]. {Auditimet përfshijnë përputhshmërinë e pagesave me rregullat e Komunitetit, për sa i përket aftësisë së strukturave administrative akredituese për të siguruar kjo përputhshmëri është kontrolluar përpara bërjes së pagesës}[4].

Besoj se auditimet e kryera nga unë japin një bazë të arsyeshme për opinionin tim.

3. Shtrirja e shqyrtimit

Unë e kam kryer shqyrtimin në përputhje me nenin 29(2)(b) IPA IR.

<Shtrirja e shqyrtimit tonë ishte jo për të krijuar një opinion mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në deklaratën përfundimtare të shpenzimeve që i dorëzohet Komisionit.>[5] <Nuk pati kufizime në shtrirjen e shqyrtimit.>[5]

Shtrirja u kufizua edhe më tepër nga faktorët e mëposhtëm:

(a)…

[1] Sipas nenit 29(2)(b) të rregullores zbatuese IPA.
[2] Opsioni për komponentin 5 mbetet për tu përcaktuar.
[3] Kur është e përshtatshme, në çdo rast është e paaplikueshme për komponentin 5.
[4] Opsionale për komponentin 5.
[5] Opsion që mbetet për t'u përcaktuar sipas komponentëve.

(b)…

(c)… etj.

(Tregoni kufizimet në shtrirjen e shqyrtimit, për shembull ndonjë problem sistemik, dobësitë në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, mungesa e dokumentacionit mbështetës, çështje nën procedim ligjor etj., dhe vlerësoni shumat e shpenzimeve dhe kontributin e Komunitetit që janë prekur. Nëse autoriteti auditues e gjykon se kufizimet nuk kanë pasur impakt në shpenzimet përfundimtare të deklaruara, atëherë kjo duhet të shkruhet.)

4. Gabimet dhe parregullsitë

{Shkalla e gabimeve dhe rastet me parregullsi të gjetura nga puna audituese nuk janë të tilla sa për të penguar një opinion pa të meta, duke ditur që NKA i ka administruar në mënyrë të kënaqshme dhe duke pasur parasysh shpeshtësinë e këtyre gabimeve dhe parregullsive në raport me kohën.}

Ose

{Shkalla e gabimeve dhe rastet me parregullsi të gjetura nga puna audituese dhe mënyra si ato janë administruar nga NKA, janë të tilla sa për të penguar një opinion pa të meta. Një listë e këtyre rasteve jepet në raportin përfundimtar të aktiviteteve audituese, bashkë me natyrën sistemike me të cilën ndodhin, si dhe shkallën e problemit.}

5. Opinioni i audituesve për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve

{Opsioni 1 – Opinion i pakualifikuar

(Kur nuk ka pasur kufizime në shtrirjen e ekzaminimit dhe kur shkalla e gabimit dhe rastet me parregullsi janë administruar nga NKA në mënyrë të tillë që nuk pengojnë dhënien e një opinioni të pakualifikuar.).

{Bazuar në ekzaminimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë}, opinioni im është që llogaritë financiare dorëzuar Komisionit për operacionet nën komponentin IPA {1 deri në 5} për periudhën nga (data) deri më (datë) (veçanërisht deklarata e shpenzimeve) janë prezantuar drejt në të gjitha aspektet materiale <, përfshirë ato që i përkasin ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve>1 {si dhe procedurat e kontrollit të brendshëm kanë operuar në mënyrë të kënaqshme}[3] .}

Ose

{Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë}, opinioni im është që deklarata përfundimtare e shpenzimeve paraqet drejt në të gjitha aspektet materiale - <përfshirë ato që i përkasin ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve>[7] – shpenzimet e paguara nën programin operativ me referencë:…të komponentit IPA {1 deri në 5} për periudhën nga (data) deri më (data), dhe se aplikimi për pagesën e bilancit përfundimtar të kontributit të Komunitetit për këtë program, është i vlefshëm.}

Auditimet e mia u kryen nga data DD/MM/20YY deri më DD/MM/20YY.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit audites përgjegjës)}

Opsioni 2 – Opinion i kualifikuar

(Kur ka pasur kufizime në shtrirjen e ekzaminimit dhe/ose shkalla e gabimeve dhe rastet me parregullsi, si dhe mënyra si këto janë administruar nga NAO, bëjnë që opinioni të jetë i kualifikuar, por që nuk justifikojnë një opinion të pafavorshëm për të gjitha shpenzimet në fjalë.).

{Bazuar në ekzaminimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë}, opinioni im është që llogaritë financiare dorëzuar Komisionit për operacionet nën komponentin IPA {1 deri në 5} për periudhën nga (data) deri më (datë) (veçanërisht deklarata e shpenzimeve) janë prezantuar drejt në të gjitha aspektet materiale <, përfshirë ato që i përkasin ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve>[7] {si dhe procedurat e kontrollit të brendshëm kanë operuar në mënyrë të kënaqshme}[3], përveç aspekteve të mëposhtme:

(a)…

[1] Opsionale për komponentët aty ku është e nevojshme (shiko shënimin 6 sipër).

(b)…

(c)… etj.

(Tregoni mangësitë dhe në veçanti organet e prekura dhe shpjegoni, për shembull, nëse kanë natyrë përsëritëse apo ndodhin vetëm një herë.).

Sipas vlerësimit tim, impakti i mangësive është {eur} {%}… i shpenzimeve totale të deklaruara, {që i korrespondon {EUR} {%} të kontributit publik}. Kontributi i Komunitetit i prekur është …}.

Ose

[Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë}, opinioni im është që deklarata përfundimtare e shpenzimeve paraqet drejt të gjitha aspektet material, < përfshi ato që i përkasin ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve>[7] për shpenzimet e paguara nën programin operativ me referencë…i komponentit IPA {1 deri në 5} për periudhën nga (data) deri më (datë), dhe se aplikimi për pagesën e bilancit përfundimtar të kontributit të Komunitetit për këtë program është i vlefshëm, përveç çështjeve të referuara në pikën 3 më lart dhe/ose vëzhgimeve në pikën 4 që flet për shkallën e gabimit dhe rastet me parregullsi, si dhe mënyrën si janë administruar ato nga NKA.

Sipas vlerësimit tim, impakti i mangësive është {eur} {%)… i shpenzimeve totale të deklaruara, {që i korrespondon {eur} {%} të kontributit publik}. Kontributi i Komunitetit i prekur është…}.

Auditimet e mia u kryen nga data DD/MM/20 YY deri më DD/MM/20 YY.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit auditues përgjegjës)

Opsioni 3 – Opinion i kundërt

(Kur natyra dhe shtrirja e gabimeve dhe e rasteve me parregullsi, si dhe mënyra si janë administruar nga NKA është kaq e përciptë, saqë një mangësi cilësohet e pamjaftueshme për të zbuluar pasaktësinë e deklaratës përfundimtare në tërësi.).

{Bazuar në ekzaminimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë} dhe veçanërisht për sa i përket natyrës dhe shtrirjes së gabimeve dhe rasteve me parregullsi, si dhe faktin që ato nuk janë administruar kënaqshëm nga NKA siç parashikon pika 4, opinioni im është se llogaritë financiare dorëzuar Komisionit për opearcionet nën komponentin IPA {1 deri në 5} për periudhë nga (data) deri më (datë), nuk janë paraqitur drejtë, në të gjitha aspektet materiale {dhe procedurat e kontrollit të brendshëm nuk kanë operuar në mënyrë të kënaqshme}[3].}.

Ose

{Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë}, opinioni im është se deklarata përfundimtare e shpenzimeve nuk është paraqitur drejt, në të gjitha aspektet material, <përfshi ato që i përkasin ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve>[7] për shpenzimet e paguara nën programin operativ me referencë:… i komponentit IPA {1 deri në 5} për periudhën nga (data) deri më (datë), dhe se aplikimi për pagesën e bilancit përfundimtar të kontributit të Komunitetit për këtë program nuk është i vlefshëm.}

Auditimet e mia u kryen nga data DD/MM/20 YY deri më DD/MM/20 YY.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma

Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit auditues përgjegjës)}

Opsioni 4 – Mungesë opinioni

(Kur ka pasur kufizime të mëdha në shtrirjen e shqyrtimit, aq sa nuk mund të arrihet asnjë përfundim mbi besueshmërinë e deklaratës përfundimtare të shpenzimeve, pa punë të konsiderueshme të mëtejshme).

{Bazuar në shqyrtimin e lartpërmendur që mbulon punën audituese të kryer sipas nenit 29(2)(b) IPA IR {dhe punët shtesë të kryera nga unë, dhe veçanërisht çështjet e referuara në pikën 3, unë e kam të pamundur të shpreh një opinion.

(Vendi dhe data e lëshimit

_____

Firma
Emri dhe titulli zyrtar ose funksioni i kryetarit të autoritetit auditues përgjegjës)}
- {për dijeni: Nëpunësit kombëtar të autorizuar (NKA) të (vendi)}